



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT**

**KURRIKULA PËR SHKOLLAT ME DREJTIM
TË ORIENTUAR ARTISTIK**

ARSIMI I MESËM I LARTË

DEGA: ART FIGURATIV

KLASA: X & XII

Tiranë, 2016



PUNUAN PROGRAMET MËSIMORE:

Koordinatore:

Majlinda HALA

IZHA

Drejtues dhe grupi i mësuesve të degës art figurativ, shkolla artistike “Jordan Misja”

Redaktor letrar:

Elfrida Begaj

IZHA

PËRMBAJTJA:

- 1. Qëllimet e arsimit të mesëm me drejtim të orientuar artistik, dega Art figurativ.**
- 2. Profili artistik i nxënësve në përfundim të arsimit, dega Art figurativ.**
 - 2.1 Kriteret e pranimit të nxënësve në arsimin e mesëm me drejtim të orientuar artistik në degën Art figurativ.
 - 2.2 Kompetencat e përgjithshme artistike të përfutuar nga nxënësit, dega Art figurativ në përfundim të arsimit të mesëm me drejtim të orientuar artistik.
 - 2.3 Kompetencat specifike artistike të përfutuar nga nxënësit, dega Art figurativ në përfundim të mesëm me drejtim të orientuar artistik.
 - 2.4 Mundësitë e arsimimit të mëtejshëm dhe të punësimit në përfundim të mesëm me drejtim të orientuar artistik, dega Art figurativ.
- 3. Plani mësimor, arsimi i mesëm me drejtim të orientuar artistik, dega Art figurativ**
- 4. Udhëzime për zbatimin e planit mësimor, arsimi i mesëm me drejtim të orientuar artistik, dega Art figurativ**
- 5. Udhëzime për zbatimin e procesit mësimor, dega Art figurativ**
- 6. Udhëzime për vlerësimin e nxënësve dhe zhvillimin e provimeve**
- 7. Të dhëna për diplomën dhe certifikatën që përfitohet në përfundim të arsimit të mesëm me drejtim të orientuar artistik, dega Art figurativ**
- 8. Programet e përgjithshme të lëndëve: *teorike-artistike***
- 9. Programet e lëndëve: *teorike-praktike-artistike***
- 10. Programet e lëndës së *specialiteti***

1. QËLLIMET E ARSIMIT TË MESËM ME DREJTIM TË ORIENTUAR ARTISTIK, DEGA ART FIGURATIV.

Qëllimi kryesor i arsimit profesional artistik në degën Art figurativ, është *zhvillimi i aftësive profesionale artistike për të prezantuar artin në shkollë dhe jashtë saj dhe përgatitja e tyre në aftësimin e mëtejshëm arsimor.*

Për të realizuar këtë, dega e artit figurativ, u krijon nxënësve:

-) mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
-) mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat vizuale dhe artistike, të bazuara në njohuritë, shprehjet, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin apo vazhdimin drejt arsimit më të plotë artistik të mëtejshëm;
-) mbështetje për t'u njohur me fushën e artit figurativ dhe sigurimit të mjedisit të studimit dhe punës në përputhje me standardet bashkëkohore;
-) mbështetje për t'u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike tradicionale dhe bashkëkohore, që lidhen dhe ndihmojnë zhvillimin artistik profesional përkatës;
-) mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, zhvillimin vizual e artistik, intelektual, aftësitë sipërmarrëse, si dhe vlerat morale;
-) mbështetje për t'u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht, për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme artistike;
-) mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës në klasë dhe mjedise të tjera artistike.

2. PROFILI I NXËNËSVE NË PËRFUNDIM TË ARSIMIT TË MESËM ME DREJTIM TË ORIENTUAR ARTISTIK, DEGA ART FIGURATIV.

2.1 Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin e mesëm me drejtim të orientuar artistik në degën Art figurativ.

Në shkollat e mesme me drejtim të orientuar artistik, që ofrojnë arsimimin dhe përgatitjen e nxënësve në degën Art figurativ, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

-) kanë mbaruar arsimin bazë (AMU);
-) janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit artistik.

2.2 Kompetencat e përgjithshme artistike të nxënësit në përfundim të arsimit të mesëm me drejtim të orientuar artistik në degën Art figurativ.

Në përfundim të arsimit të mesëm me drejtim të orientuar artistik në degën **Art figurativ**, nxënësit do të zotërojnë këto kompetenca të përgjithshme artistike kryesore:

-) komunikojnë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tyre dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme të artit dhe specialitetit që studiojnë;
-) përdorin burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve rreth artit, të nevojshme për zhvillimin e tyre personal dhe artistik;
-) nxisin potencialin e tyre të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm të arritjeve personale artistike për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficientë në punën e tyre;
-) angazhohen fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave artistike të ndryshme;
-) respektojnë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese dhe bashkëpunimi në grup në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale;
-) tregojnë vetëkontroll dhe vetëbesim gjatë ushtrimit të veprimtarive të tyre artistike;
-) organizojnë drejt procesin e të nxënësve të tyre, duke shfaqur gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;

-) respektojnë parimet e punës në grup dhe bashkëpunojnë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
-) vlerësojnë dhe vetë-vlerësojnë punët e veta artistike dhe të të tjerëve, nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tyre.

3. Kompetencat specifike profesionale artistike të nxënësit në përfundim të arsimit të mesëm me drejtim të orientuar artistik në degën Art figurativ.

Në përfundim të arsimit të mesëm me drejtim të orientuar artistik në degën **Art figurativ**, nxënësit do të jenë të aftë të zotërojnë kompetencat specifike artistike:

-) përdorin në mënyrë profesionale teknikat të ndryshme për realizimin artistik të punëve, duke shprehur idetë e tyre;
-) riprodhojnë dhe interpretojnë artin që studiojnë dhe krijojnë, duke pasqyruar njohuritë e gjuhës vizuale në punët e tyre;
-) krijojnë duke u mbështetur në elemente dhe parimet kompozicionale të artit pamor;
-) zgjedhin me kompetencë profesionale materialet dhe teknikën e duhur në procesin e tyre krijues në përshtatje me temën dhe idenë;
-) përshkruajnë procesin e krijimit dhe të realizimit të punëve artistike me kompetencë dhe në mënyrë profesionale;
-) klasifikojnë veprat e artit nëpërmjet: *periudhave, përmbajtjeve, temave, stileve, metodave, teknikave dhe materialeve*;
-) analizojnë duke mbajtur një qëndrim individual ndaj veprave të ndryshme arti, sipas karakteristikave dhe veçorive të tyre;
-) kuptojnë rolin e teknologjisë në krijimin e formave të reja shprehëse në artin pamor;
-) analizojnë, duke interpretuar me kompetencë profesionale veçoritë artistike të realizimit në punën e tij/saj dhe të shokut/shoqes;
-) vlerësojnë punët e veta dhe të shokut, duke mbajtur një qëndrim profesional.

4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të të arsimit të mesëm me drejtim të orientuar artistik në degën Art figurativ.

Përfundimi i arsimimit në degën e Artit figurativ, i pajis nxënësit me dëftesën apo diplomën e një artisti gjysmë të kualifikuar (ndihmës) në këtë drejtim, me të drejtë për vazhdimin e arsimimit në nivelin e mëtejshëm universitar (Akademia e Arteve) në një nga profilet mësimore të drejtimit pikturë dhe skulpturë. Po ky arsimim i jep mundësi nxënësve t'i drejtohen tregut të punës si *grafik i mesëm* në televizione ose studio grafike, *ndihmës kostumograf* në teatër ose televizion, *butaforist* në teatrin e kukullave, *ndihmës* në studiot e qeramikës, *ndihmës* në dekorin e qytetit etj.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
MINISTRI

Nr..... Prot.

Tiranë, më2016

**PLANI MËSIMOR PËR ARSIMIN E MESËM TË ORIENTUAR (ARTISTIKE)¹,
VITI SHKOLLOR 2016 – 2017**

MIRATOHET

**MINISTËR
LINDITA NIKOLLA**

**DEGA: ARTI FIGURATIV
SPECIALITETI : Grafika, Skenografi, Tekstil**

Nr.	Fushat e të nxënit/Lëndët	Shkalla 5		Shkalla 6
		Klasa 10 (orë/javë)	Klasa 11 (orë/javë)	Klasa 12 (orë/javë)
A.	KURRIKULA E PËRGJITHSHME			
I.	GJUHËT DHE KOMUNIKIMI	5	5	6
I.1	Gjuhë shqipe	2	2	1
I.2	Letërsi	1	1	2
I.3	Gjuhë e huaj e parë	2	2	3
II.	MATEMATIKË	2	3	3
III.	SHKENCAT E NATYRËS	5	0	0
III.1	Fizikë	2	0	0
III.2	Kimi	2	0	0
III.3	Biologji	1	0	0
IV.	SHOQËRIA DHE MJEDISI	3	5	0
IV.1	Shkenca sociale (Qytetari ² , Filozofi ³)	1	1	0
IV.2	Histori	1	2	0
IV.3	Gjeografi	1	2	0
V.	TEKNOLOGJI DHE TIK	1	1	0
V.1	TIK ⁴	1	1	0
VI.	EDUKIMI FIZIK, SPORTE DHE	2	2	2

¹ Ky plan mësimor fillon të zbatohet për herë të parë në vitin shkollor 2016-2017, në klasën e dhjetë.

² Qytetaria zhvillohet në klasën e 10-të.

³ Filozofia zhvillohet në klasën e 11-të.

⁴ Lënda "specialitet" (5+1) do të zhvillojë edhe 1 orë *Informatikë të specializuar* në varësi të specialitetit.



	SHËNDETI			
VI.1	Edukimi Fizik, sporti dhe shëndeti	2	2	2
Shuma (Kurrikula e përgjithshme)		18	16	11
B	KURRIKULA ARTISTIKE	21	26	29
VII	LËNDËT TEORIKE ARTISTIKE	2	4	5
VII.1	Perspektivë	0	0	1
VII.2	Histori arti	0	2	4
VII.3	Anatomi artistike	2	2	0
VIII	LËNDËT PRAKTIKE ARTISTIKE	15	16	16
VIII.1	Vizatim	8	8	8
VIII.2	Pikturë/skulpturë	7	8	8
IX	SPECIALITET	4	6	8
IX.1	<i>Grafika, Skenografi, Tekstil</i>	4	5	8
IX.2	Informatikë të specializuar	0	1	0
C	KURRIKULA NË BAZË SHKOLLE⁵	0-2	0-2	0-2
TOTALI A+B +C (Nr. i orëve javore gjithsej)		39/41	42/44	40/42

¹Brenda hapësirës së kurrikulës në bazë shkollezhvillohet dhe shërbimi komunitar. Shërbimi komunitar është i detyruar të kryhet në 18 orë, në klasën e 10-të dhe/ose në klasën e 11-të.

Orët e tjera të kurrikulës në bazë shkolle nuk janë të detyruara. Ato i mundësojnë shkollës zbatimin e kurrikulës lidhur me projekte ndërkurrikulare/veprimtari të tjera shkollore.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
MINISTRI

Nr..... Prot.

Tiranë, më2016

**PLANI MËSIMOR PËR ARSIMIN E MESËM TË ORIENTUAR (ARTISTIKE)⁶,
VITI SHKOLLOR 2016 – 2017**

**MIRATOHET
MINISTËR
LINDITA NIKOLLA**

**DEGA: ARTI FIGURATIV
SPECIALITETI :Qeramikë, Gdhendje gur-dru**

Nr.	Fushat e të nxënit/Lëndët	Shkalla 5		Shkalla 6
		Klasa 10 (orë/javë)	Klasa 11 (orë/javë)	Klasa 12 (orë/javë)
A.	KURRIKULA E PËRGJITHSHME			
I.	GJUHËT DHE KOMUNIKIMI	5	5	6
I.1	Gjuhë shqipe	2	2	1
I.2	Letërsi	1	1	2
I.3	Gjuhë e huaj e parë	2	2	3
II.	MATEMATIKË	2	3	3
III.	SHKENCAT E NATYRËS	5	0	0
III.1	Fizikë	2	0	0
III.2	Kimi	2	0	0
III.3	Biologji	1	0	0
IV.	SHOQËRIA DHE MJEDISI	3	5	0
IV.1	Shkenca sociale (Qytetari ⁷)	1	1	0
IV.2	Histori	1	2	0
IV.3	Gjeografi	1	2	0
V.	TEKNOLOGJI DHE TIK	1	1	0
V.1	TIK ⁸	1	1	0

⁶Ky plan mësimor fillon të zbatohet për herë të parë në vitin shkollor 2016-2017, në klasën e dhjetë.

⁷ Qytetaria zhvillohet në klasën e 10- 11-të.

⁸Lënda "specialitet" (5+1) do të zhvillojë edhe 1 orë Informatikë të specializuarnë varësisht specialitetit.



VI.	EDUKIMI FIZIK, SPORTE DHE SHËNDETI	2	2	2
VI.1	Edukimi Fizik, sporti dhe shëndeti	2	2	2
Shuma (Kurrikula e përgjithshme)		18	16	11
B	KURRIKULA ARTISTIKE	21	26	29
VII	LËNDËT TEORIKE ARTISTIKE	2	4	5
VII.1	Perspektivë	0	0	1
VII.2	Histori arti	0	2	4
VII.3	Anatomi artistike	2	2	0
VIII	LËNDËT PRAKTIKE ARTISTIKE	15	16	16
VIII.1	Vizatim	8	8	8
VIII.2	Pikturë/skulpturë	7	8	8
IX	SPECIALITET	4	6	8
IX.1	<i>Qeramikë, Gdhendje gur-dru</i>	4	5	8
IX.2	Informatikë të specializuar	0	1	0
C	KURRIKULA NË BAZË SHKOLLE⁹	0-2	0-2	0-2
TOTALI A+B + C (Nr. i orëve javore gjithsej)		39/41	42/44	40/42

¹Brenda hapësirës së kurrikulës në bazë shkollezhvillohet dhe shërbimi komunitar. Shërbimi komunitar është i detyruar të kryhet në 18 orë, në klasën e 10-të dhe/ose në klasën e 11-të.

Orët e tjera të kurrikulës në bazë shkolle nuk janë të detyruara për nxënësit, ato i mundësojnë shkollës zbatimin e kurrikulës lidhur me projekte ndërkurrikulare/veprimtari të tjera shkollore.



4. UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PLANIT MËSIMOR

1. Kohëzgjatja e arsimit të mesëm me drejtim të orientuar artistik, dega Art figurativ është:

) 3- vjet për nxënësit që vijnë nga arsimi i bazë të përgjithshme.

2. Kohëzgjatja e vitit shkollor për sistemin 3-vjeçar është:

) Në klasën e 10 viti shkollor ka gjithsej 34 javë mësim. Dy javë mësimore janë praktika mësimore. Në total janë 36 javë mësimore.

) Në klasën e 11 viti shkollor ka gjithsej 34 javë mësim. Dy javë mësimore janë praktika mësimore. Në total janë 36 javë mësimore.

) Në klasën e 12 viti shkollor ka gjithsej 34 javë mësim.

3. Kurrikula e arsimit të mesëm me drejtim të orientuar artistik, dega Art figurativ përbëhet nga:

) lëndët e kulturës së përgjithshme;

) lëndët teorike-artistike;

) lëndët praktike-artistike dhe lëndët e specialitetit.

5. UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PROCESIT MËSIMOR

Mësuesit e lëndëve teorike artistike dhe të specialiteteve duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënësit aktiv të nxënësve dhe të krijojnë tek ta kompetenca artistike, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që **planifikimi i mësimdhënies** të bazohet në një proces fillestar, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si:

- niveli i hyrjes së nxënësve;
- përmbajtja e lëndëve teorike artistike;
- praktike dhe speciale;
- shkallën e integritit të tyre;
- rezultatet konkretë që do të arrihen;
- mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore, etj.

Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtuesve të shkollave.

Hapësira në atelie duhet të zhvillohet me grupe 6-8 nxënës.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është edhe *motivimi nxënësve*. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e specialitetit për të cilën ata mësojnë.

Mësuesit duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm aftësitë praktike por edhe njohuritë teorike dhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi.

6. UDHËZIME PËR VLERËSIMIN DHE PROVIMET

Vlerësimi i nxënësve në lëndët teorike praktike dhe të specialitetit bëhet nga mësuesit me metoda dhe instrumente vlerësimi të përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me notat 4-10 si gjatë vitit shkollor ashtu edhe në provimet përfundimtare.

Vlerësimi në shkollën e mesme me drejtim të orientuar artistik, dega Art figurativ bazohet në disa shtylla kryesore i cili detajohet nga komisionet përkatëse të ngritura nga shkolla duke përcaktuar nivelin e arritjes për çdo nxënësi. Këto shtylla që do të udhëheqin vlerësimin e punëve artistike në këtë degë pavarësisht specialitetit janë:

- realizimi i gjuhës artistike (elementeve dhe parimeve) në punët artistike;

- kompozimi i punëve artistike;
- përdorimi i teknikave artistike në funksion të realizimit të punëve artistike;
- individualiteti artistik në punët artistike.

Çdo komision për vlerësimin e punëve të nxënësve detajon më tej këto komponentë në varësi të specialitetit, qëllimit të punëve artistike dhe aftësive të nxënësve sipas vitit shkollor.

Në përfundim të kësaj shkolle, nxënësi i arsimuar në degën Art figurativ në sistemin 3-vjeçar, i nënshtrohet provimeve të mëposhtme:

1. Provimi i formimit artistik
2. Provimi i specialitetit artistik
3. Provimi i Maturës Shtetërore

Në këto provime ata vlerësohen për shkallën e përvetësimit të kompetencave mbi kulturën e përgjithshme dhe ato artistike.

7. TË DHËNA PËR DIPLOMËN DHE CERTIFIKATËN QË FITOHET NË PËRFUNDIM TË ARSIMIT TË MESËM ME DREJTIM TË ORIENTUAR ARTISTIK, NË DEGËN ART FIGURATIV.

Në përfundimin e suksesshëm të shkollës së mesme artistike, shkolla e pajis nxënësin me diplomën dhe certifikatën e cila njihet në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modelit të miratuar nga MAS-i, të cilat përmbajnë:

- a. të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit;
- b. të dhëna të rezultateve të arritura nga nxënësi;
- c. rezultatet në lëndët e përgjithshme, lëndët teorike-artistike, lëndët teorike-praktike-artistike dhe lënda e specialitetit, për çdo vit shkollor si dhe rezultatet e dy provimeve si më sipër.
- d. rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore.

8. PROGRAMET E PËRGJITHSHME TË LËNDËVE: TEORIKE-ARTISTIKE

Dega: ART FIGURATIV
Pikturë dhe Skulpturë
Lënda: Histori e artit shqiptar
Klasa: 11-të
Kohëzgjatja: 34 javë x 2 orë/javë = 68 orë

1. Rezultatet e pritshme të të nxënit

Në përfundim të këtij programi, nxënësi/ja:

-) njeh zhvillimin e artit shqiptar;
-) identifikon vepra të ndryshme të artit shqiptar;
-) shqyrton dhe mban qëndrim ndaj veprave dhe përfaqësuesve të tyre;
-) shpjegon karakteristikat e artit shqiptar në periudha të ndryshme;
-) analizon karakteristikat e artit dhe të veprave shqiptare, duke gjykuar mbi to;
-) mban qëndrim kritik, duke vlerësuar artin shqiptar në periudha të ndryshme kohore;
-) kultivon shijet artistike, përmes njohjes, krahasimit dhe përzgjedhjes së veprave të artit.

2. Përmbajtja tematike e lëndës “Histori e artit shqiptar”

Tematika	Tema mësimore	Rezultatet e pritshme	Orët
ARTI SHQIPTAR	1. Arti i periudhës parahistorike	<i>Nxënësi/ja:</i>	2 orë
	2. Arti ilir) identifikon veprat e artit dhe zhvillimet artistike në lidhje me periudhën dhe kontekstin historik në Shqipëri;	4 orë
	3. Arti i qyteteve antike bregdetare		4 orë
	4. Arti paleokristian		2 orë
	5. Arti i arbërve të hershëm		2 orë
	6. Arti bizantin) diskuton rreth historisë së artit duke përdorur një fjalor të zgjeruar artistik;	6 orë
	7. Arti pasbizantin i shek. XVI-XIX) përshkruan karakteristikat dalluese të veprave të artit në periudha historike ndryshme;	6 orë
	8. Arti popullor: qytetet, arkitektura, artizanati)) diskuton kushtet sociale që ndikuan veprat e artit;	4 orë
	9. Arti i rilindjes kombëtare shqiptare) përshkruan, analizon, interpreton dhe vlerëson vepra arti, objekte të trashëgimisë kulturore shqiptare në kontekstin historik dhe në kontekstin social-kulturor;	6 orë
	10. Arti i periudhës së pavarësisë) përshkruan simbolet në veprat e artit në lidhje me kontekstin historik;	6 orë
	11. Arti i periudhës pas çlirimit (pas luftës së dytë botërore)		12 orë
	12. Shikim i përgjithshëm: konkluzione		2 orë
	13. Vizita në muzeun arkeologjik Tiranë		6 orë
	14. Vizita në muzeun historik kombëtar		6 orë

		<ul style="list-style-type: none">) analizon elementët e gjuhës vizuale, teknikën e përdorur, aspektet historike në një vepër arti. 	
--	--	---	--

3. KËRKESA PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Kjo lëndë kërkon që të japë informacion të pasur përmes materialit të shkruar (teksteve apo leksioneve), duke u mbështetur përditshëm në mjetet pamore. Programi shtjellohet me rrugë shkencore në hapësirë dhe në kohë, duke zbuluar jo vetëm lidhjet e artit me shoqërinë dhe vartësinë e tyre reciproke, por dhe ligjet e brendshme të zhvillimit të artit. Në shërbim të procesit mësimor zhvillohen vizita dhe ekskursionet në ato vende ku është përqendruar një trashëgimi e pasur historike dhe kulturore-artistike. Gjithashtu, materiali bazë për zhvillimin e kësaj lëndë është teksti mësimor i nxënësit ose burime të ndryshme letrare të gjetura përmes internetit apo literaturave të ndryshme.

4. VLERËSIMI

Nxënësi/ja është i nivelit SHUMË TË MIRË

Nxënësi/ja arrin këtë nivel, kur:

-) njeh shumë saktë zhvillimin e historisë së artit dhe flet rreth tij;
-) dallon saktë vepra të ndryshme të artit shqiptar dhe krijuesit e tyre;
-) shpjegon saktë dhe dukshëm karakteristikat e artit shqiptar në periudha të ndryshme;
-) mban një qëndrim të qartë, duke vlerësuar saktë artin shqiptar në etapa të ndryshme të zhvillimit të artit figurativ.

Nxënësi/ja është i nivelit të MIRË

Nxënësi/ja arrin këtë nivel, kur:

-) njeh dhe flet për zhvillimin e historisë së artit shqiptar;
-) dallon vepra të ndryshme të artit shqiptar;
-) shpjegon karakteristikat e artit shqiptar në periudha të ndryshme;
-) mban një qëndrim të qartë, duke vlerësuar saktë artin shqiptar në etapa të ndryshme të zhvillimit të artit figurativ.

Nxënësi/ja është i nivelit të MJAFTUESHËM

Nxënësi/ja arrin këtë nivel, kur:

-) njeh mjaftueshëm zhvillimin e historisë së artit shqiptar;
-) dallon ndonjë vepër të artit shqiptar;
-) arrin të shpjegojë disa karakteristika të artit shqiptar në periudha të ndryshme;
-) arrin të mbajë një qëndrim të qartë, duke vlerësuar artin shqiptar në etapa të ndryshme të zhvillimit të artit figurativ.

Dega: ART FIGURATIV
Pikturë dhe Skulpturë
Lënda: Histori e artit botëror
Klasa: 12-të
Kohëzgjatja: 34 javë x 4 orë/javë = 136 orë

1. Rezultatet e pritshme të të nxënit

Në përfundim të këtij programi, nxënësi/ja:

-) njeh zhvillimin e artit botëror dhe përfaqësuesve kryesorë në periudhat e marra në studim;
-) identifikon dhe shqyrton vepra të ndryshme të përfaqësuesve kryesorë të artit botëror;
-) shpjegon karakteristikat të veprave të artit botëror në periudha të ndryshme;
-) mban qëndrim kritik, duke vlerësuar vepra të artit botëror në periudha të ndryshme kohore;
-) kultivon shijet artistike, përmes njohjes, krahasimit dhe vlerësimit së veprave të artit.

2. Përmbajtja tematike e lëndës Histori e artit botëror

Tematika	Tema mësimore	Rezultatet e pritshme	Orët
Arti në parahistori	1. 1.Arti i parahistorisë	<i>Nxënësi/ja:</i>) Shpjegon karakteristikat e artit në parahistori duke u mbështetur në artefaktet e kësaj periudhe.	2 orë
Arti në antikitet	2.1.Arti egjiptian 2.2.Arti i Mesopotamisë (asiro-babilonas) 2.3.Arti kreto-mikenas (egjean) 2.4.Arti i Greqisë antike 2.5.Arti etrusk 2.6.Arti romak) zbulon karakteristikat dalluese të qytetërimeve në antikitet;) identifikon veprat e artit dhe zhvillimet artistike të qytetërimeve antike në lidhje me periudhën historike dhe vendin;) përshkruan karakteristikat dalluese të veprave të artit të qytetërimeve antike në periudha historike dhe në kontekste kulturore të ndryshme;) përshkruan, analizon, interpreton dhe vlerëson vepra arti, objekte të trashëgimisë kulturore të qytetërimeve antike, në kontekstin historik dhe në kontekstin social kulturor;) analizon elementët e gjuhës vizuale, teknikën e përdorur, aspektet historike në një vepër arti.	8 orë 4 orë 2 orë 10 orë 2 orë 8 orë

Arti në mesjetë	3.1.Arti bizantin 3.2.Arti romanik (norman) 3.3.Arti gotik	<ul style="list-style-type: none">) zbulon karakteristikat e artit në mesjetë;) identifikon veprat e artit dhe zhvillimet artistike në mesjetë në lidhje me periudhën historike dhe vendin;) përshkruan karakteristikat dalluese të veprave të artit në mesjetë në kontekste historike dhe kulturore të ndryshme;) përshkruan, analizon, interpreton dhe vlerëson vepra arti, objekte të trashëgimisë kulturore, në kontekstin historik dhe në kontekstin social kulturor;) analizon elementët e gjuhës vizuale, teknikën e përdorur, aspektet historike në një vepër arti. 	4 orë 4 orë 4 orë
Arti në rilindje	4.1.Arti para rilindjes 4.2.Artet e rilindjes evropiane	<ul style="list-style-type: none">) zbulon karakteristikat e artit në rilindje;) identifikon veprat e artit dhe zhvillimet artistike në rilindje në lidhje me periudhën historike dhe vendin;) përshkruan karakteristikat dalluese të veprave të artit në rilindje në kontekste historike dhe kulturore të ndryshme;) përshkruan, analizon, interpreton dhe vlerëson vepra arti, objekte të trashëgimisë kulturore, në kontekstin historik dhe në kontekstin social kulturor;) analizon elementët e gjuhës vizuale, teknikën e përdorur, aspektet historike në një vepër arti. 	4 orë 18 orë
Arti Barok	5.1. Arti barok:) <i>Itali,</i>) <i>Spanjë,</i>) zbulon dhe identifikon karakteristikat e zhvillimit të artit barok në vende të	

	<ul style="list-style-type: none">) <i>Flander,</i>) <i>Holandë,</i>) <i>Francë.</i> 	<ul style="list-style-type: none">) ndryshme;) përshkruan karakteristikat dalluese të veprave të artit barok në kontekste historike dhe kulturore të ndryshme;) përshkruan, analizon, interpreton dhe vlerëson vepra arti, objekte të trashëgimisë kulturore, në kontekstin historik dhe në kontekstin social kulturor;) analizon elementët e gjuhës vizuale, teknikën e përdorur, aspektet historike në një vepër arti. 	18 orë
Arti neoklasik	6.1. Arti neoklasik	<ul style="list-style-type: none">) zbulon dhe identifikon karakteristikat e zhvillimit të artit neoklasik;) përshkruan, analizon, interpreton dhe vlerëson vepra arti, objekte të trashëgimisë kulturore, në kontekstin historik dhe në kontekstin social kulturor;) analizon elementët e gjuhës vizuale, teknikën e përdorur, aspektet historike në një vepër arti;) diskuton ose shkruan rreth historisë së artit duke përdorur një fjalor të zgjeruar artistik. 	2 orë
Arti romantik	7.1. Arti romantik	<ul style="list-style-type: none">) zbulon dhe identifikon karakteristikat e zhvillimit të artit romanik;) përshkruan, analizon, interpreton dhe vlerëson vepra arti, objekte të trashëgimisë kulturore, në kontekstin historik dhe në kontekstin social kulturor;) analizon elementët e gjuhës vizuale, teknikën e përdorur, aspektet historike në një vepër arti;) diskuton ose shkruan rreth 	4 orë

		historisë së artit duke përdorur një fjalor të zgjeruar artistik.	
Arti realist dhe në shekullin XIX	8.1.Arti realist (realizmi kritik)) identifikon dhe përshkruan karakteristikat e zhvillimit të artit realist;	6 orë
	8.2.Arti evropian dhe i vendeve të tjera në fund të shek. XIX) përshkruan karakteristikat dalluese të veprave të artit dhe të artistëve në fund të shek. XIX në Evropë dhe në vende të tjera.) përshkruan, analizon, interpreton dhe vlerëson vepra arti, në kontekstin historik dhe në kontekstin social kulturor;) analizon elementët e gjuhës vizuale, teknikën e përdorur, aspektet historike në një vepër arti;) diskuton ose shkruan rreth historisë së artit duke përdorur një fjalor të zgjeruar artistik.	10 orë
Arti në shekullin XX	9.1.Arti në gjysmën e parë të shek. XX) përshkruan karakteristikat dalluese të veprave të artit dhe të artistëve në gjysmën e parë dhe në gjysmën e dytë të shek. XX;	6 orë
	9.2.Arti në gjysmën e dytë të shek. XX) përshkruan, analizon, interpreton dhe vlerëson vepra arti, në kontekstin historik dhe në kontekstin social kulturor;) analizon elementët e gjuhës vizuale, teknikën e përdorur, aspektet historike në një vepër arti;) diskuton ose shkruan rreth historisë së artit duke përdorur një fjalor të zgjeruar artistik.	6 orë
Artet e popujve të tjerë	10.1. Artet e popujve të tjerë:) <i>Arti Afrika</i>) identifikon veprat e artit dhe zhvillimet artistike në lidhje me periudhën	10 orë

	<ul style="list-style-type: none">) <i>Arti Parakolumbian</i>) <i>Arti Islam</i>) <i>Arti Indian,</i>) <i>Arti i Lindjes së largët</i> 	<ul style="list-style-type: none">) historike dhe vendin;) përshkruan karakteristikat dalluese të veprave të artit në periudha historike dhe në kontekste kulturore të ndryshme;) diskuton kushtet sociale që ndikuan veprat e artit;) përshkruan, analizon, interpreton dhe vlerëson vepra arti, objekte të trashëgimisë kulturore nga kultura të ndryshme, në kontekstin historik dhe në kontekstin social kulturor;) diskuton ose shkruan rreth historisë së artit duke përdorur një fjalor të zgjeruar artistik. 	
Analizë e veprave	1. Përsëritje		2 orë

3. KËRKESA PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Kjo lëndë ka për qëllim të njohë dhe të informojë nxënësit me rrugën që ka ndjekur zhvillimi i arteve figurative gjatë historisë së njerëzimit, që nga zanafilla deri në ditët tona, me ngjarjet, përfaqësuesit dhe krijuesit e tij. Ajo, gjithashtu, synon që të ruajë një raport dialektik midis karakterit informues dhe atij analitik të materialit teorik dhe pamor.

Kjo lëndë jep informacion të pasur përmes materialit të shkruar (teksteve apo leksioneve), duke u mbështetur përditshëm në mjetet pamore. Programi shtjellohet me rrugë shkencore në hapësirë dhe në kohë, duke zbuluar jo vetëm lidhjet e artit me shoqërinë dhe vartësinë e tyre reciproke, por dhe ligjet e brendshme të zhvillimit të artit. Në shërbim të procesit mësimor zhvillohen vizita dhe ekskursionet në ato vende ku është përqendruar një trashëgimi e pasur historike dhe kulturore-artistike. Gjithashtu, materiali bazë për zhvillimin e kësaj lënde është teksti mësimor i nxënësit ose burime të ndryshme letrare të gjetura përmes internetit apo literaturave të ndryshme.

4. VLERËSIMI

Nxënësi/ja është i nivelit SHUMË TË MIRË

Nxënësi/ja arrin këtë nivel, kur:

-) njeh shumë saktë zhvillimin e historisë së artit dhe flet rreth tij;
-) dallon saktë vepra të ndryshme të artit botëror dhe krijuesit e tyre;
-) shpjegon saktë dhe dukshëm karakteristikat e artit botëror në periudha të ndryshme;
-) mban një qëndrim të qartë, duke vlerësuar saktë artin botëror në etapa të ndryshme të zhvillimit të artit figurativ.

Nxënësi/ja është i nivelit të MIRË

Nxënësi/ja arrin këtë nivel, kur:

-) njeh dhe flet për zhvillimin e historisë së artit botëror;
-) dallon vepra të ndryshme të artit botëror;
-) shpjegon karakteristikat e artit botëror në periudha të ndryshme;
-) mban një qëndrim të qartë, duke vlerësuar saktë artin botëror në etapa të ndryshme të zhvillimit të artit figurativ.

Nxënësi/ja është i nivelit të MJAFTUESHËM

Nxënësi/ja arrin këtë nivel, kur:

-) njeh pranueshëm zhvillimin e historisë së artit botëror;
-) dallon ndonjë vepër të artit botëror;
-) arrin të shpjegojë disa karakteristika të artit botëror në periudha të ndryshme;
-) mban një qëndrim të qartë, duke vlerësuar saktë artin botëror në etapa të ndryshme të zhvillimit të artit figurativ.

Dega: ART FIGURATIV
Pikturë/Skulpturë
Lënda: Anatomia artistike
Klasa : 10-të
Kohëzgjatja: 34 javë x 2 orë/javë = 68 orë

Anatomia artistike sht një disiplinë, e cila qëndron ndërmjet mjeksisë dhe artit. Ajo u bën pjesë e artit vetëm gjatë rilindjes evropiane, periudhën në të cilën si mjekët ashtu edhe artistët patën të njëjtat kërkime dhe preokupime. Që nga kjo periudhë, çdo person që ka si qëllim të vizatimit të pikturave figurative të njeriut, duhet së pari të dijë boshtet kryesore të anatomisë së njeriut. Konkretisht pamjen e jashtme dhe strukturën e tij, e cila në artin e kalon shpesh caqet e morfologjisë.

Anatomia artistike i pajis nxënësit me njohuri mbi historinë e anatomisë artistike, osteologjinë, miologjinë, artikulacionet, me proporcionet ndërmjet njerëzve në përgjithësi e pjesëve të trupit në veçanti, ndryshimet sipas seksit dhe me problemin e gravitacionit. Qëllimi i kësaj lënde nuk sht përgatitja e vizatuesve anatomistë, por ajo ngacmon thellimin e mendimit teorik e praktik mbi çështjet e trupit të njeriut në art, si dhe rafinon shikimin e nxënësit dhe avancoftësit e tij për realizimin e një forme me kërkesa artistike e profesionale si në portret, portret me duar e figurë të plotë.

Kjo lëndë synon të aftësojë nxënësit në kuptimin e ndërtimit të trupit të njeriut në aspektin morfologjik, struktural dhe dinamik. Mësimi i Anatomisë artistike bëhet më konkret kur ka ndërthurje ndërmjet studimit teorik dhe vizatimit, i cili përqendrohet në ndërtimin e kockave, të muskujve dhe strukturën e trupit të njeriut në veçanti dhe përgjithësi.

1.Rezultatet e pritshme në fund të klasës së 10-të

Në përfundim të këtij programi, nxënësi,-ja:

-) shpjegon ç' sht anatomia artistike, ç'vlerë ka për artistin dhe si evoluoi ajo gjatë shekujve;
-) njeh sistemin skeletik dhe muskulator të trupit të njeriut, format e muskujve, llojet e klasifikimit dhe funksionet e tyre, si dhe e vizaton atë duke u bazuar në format gjeometrike;
-) njeh kockat për rrethet e craniumit cerebral e visceral;
-) njeh muskujt e kokës dhe funksionin e tyre;
-) vizaton nga kujtesa kafkën dhe kokën anatomike në tri pamje duke u bazuar në format gjeometrike (ose të punojnë me plastelinë ato) si elemente të rëndësishme në përgatitjen profesionale-artistike;
-) njeh ndërtimin e skapullit dhe të klavikulës si dhe i vizaton nga kujtesa, ose i punon me plastelinë ato;
-) shpjegon muskujt e qafës dhe i vizaton sakt ato;
-) njeh ndërtimin e kockës dhe muskulatorit të trungut;
-) vizaton sakt kolonën vertebrale, sternumin dhe brinjët;
-) vizaton nga kujtesa muskujt e pjesës së përparme të trungut si elemente të rëndësishme në përgatitjen profesionale-artistike;
-) vlerëson punën e vet dhe të shokut si në anën teorike ashtu edhe në anën profesionale-artistike.

2.Përmbajtja tematike e lëndës Anatomici artistike

Tematika	Temat mësimore	Rezultatet e pritshme	Orët
Rëndësia e anatomisë në artet figurative	<p>1.1. Ç' sht anatomia</p> <p>1.2. Zhvillimi historik i kësaj lënde</p>	<p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none">) shpjegon rëndësinë dhe qëllimin e anatomisë për artistin;) shpjegon zhvillimin e anatomisë artistike gjatë historisë së artit dhe metodat e përdorimit të saj nga artistët e njohur botëror dhe shqiptarë gjatë veprimtarisë së tyre krijuese;) punon sipas metodave të punës së artistëve të njohur klasikë e modernë gjatë studimit të anatomisë artistike;) stilizon një figurë njeriu pa prishur proporcionet e tij. 	2 orë
Forma e jashtme e trupit të njeriut	<p>2.1. Ndarja e trupit në pjesë e regjione</p> <p>2.2. Përpjesëtimet dhe kanunet</p>	<ul style="list-style-type: none">) shpjegon ndarjen e trupit të njeriut sipas regjioneve ;) vizaton formën e secilit regjion duke u bazuar në format gjeometrike;) shpjegon dhe vizaton pjesët e secilit regjion të trupit pa u larguar nga forma e tij e jashtme;) shpjegon zhvillimin historik të kanuneve artistike në kultura të ndryshme;) shpjegon dhe vizaton raportet e trupit në përgjithësi dhe të çdo regjioni në veçanti duke marrë për bazë masën e kokës;) shpjegon dhe vizaton proporcionet e kokës në përgjithësi dhe të fytyrës në veçanti. 	4 orë
Osteologia dhe miologia	<p>3.1. Osteologia</p> <ul style="list-style-type: none"> - ndërtimi i përgjithshëm i skeletit të trupit të njeriut; - funksioni, karakteristikat kryesore të kockave; - vizatimi i skeletit duke 	<ul style="list-style-type: none">) shpjegon çfarë është osteologia;) shpjegon formimin e skeletit të njeriut;) shpjegon funksionet e skeletit të njeriut;) vizaton skeletin e njeriut në tri pozicione duke u bazuar në format e thjeshta gjeometrike; 	4 orë

	<p>u bazuar në format gjeometrike</p> <p>3.2. Miologia - muskujt, forma, llojet e klasifikimit dhe funksionimit të tyre</p> <p>3.3. Vizatimi i aparatit muskolor duke u bazuar në format gjeometrike</p> <p>3.4. Studimi i lidhjeve të eshtrave</p>	<p>) shpjegon çfarë është miologia;) shpjegon formimin e aparatit muskolor të njeriut;) shpjegon funksionet e muskujve të njeriut;) vizaton trupin anatomik të njeriut duke u bazuar në format e thjeshta gjeometrike;) shpjegon çfarë janë artikulationet e për çfarë shërbejnë ato.</p>	
Kafka (Cranium)	<p>4.1. Njohja e kockave të kafkës sipas anës funksionale (<i>cranium cerebrale</i>)</p> <p>4.2. Njohja e kockave të kafkës sipas anës funksionale (<i>cranium cerebrale</i>)</p> <p>4.3. Njohja e kockave të kafkës sipas anës funksionale (<i>cranium faciale</i>)</p> <p>4.4. Njohja e kockave të kafkës sipas anës funksionale (<i>cranium faciale</i>)</p> <p>4.5. Vizatimi në tërësi i formës së kafkës përball</p> <p>4.6. Vizatimi në tërësi i formës së kafkës përball</p> <p>4.7. Vizatimi në tërësi i formës së kafkës treçerek (gjysëmprofil), bardhë e zi ose me ngjyra</p> <p>4.8. Vizatimi në tërësi i formës së kafkës treçerek (gjysëmprofil), bardhë e zi ose me ngjyra</p> <p>4.9. Vizatimi në tërësi i formës së kafkës profil, bardhë e zi ose me ngjyra</p> <p>4.10. Artikulacioni temporomandibular dhe vizatimi i tij</p>	<p>) shpjegon dhe vizaton pozicionin anatomik të çdo kocke, që i duhet artistit në skeletin e kokës;) shpjegon dhe vizaton pjesët e secilës kockë;) shpjegon rëndësinë e secilës kockë si bazë dhe pikë kyçe në ndërtimin e kafkës e të portretit;) vizaton bardhë e zi dhe me ngjyra kafkën në tri pozicione duke u bazuar në format gjeometrike.</p>	10 orë
	<p>5.1. Ndryshimi i muskujve nga pikëpamja funksionale: -muskujt përtpjes; -vizatimi i tyre</p> <p>5.2. Muskujt mimikës:</p>	<p>) shpjegon dhe vizaton pozicionin anatomik të çdo muskuli të mësuar në kokën anatomike;) shpjegon rëndësinë e çdo</p>	8 orë

Muskujt e kokës dhe të fytyrës	<p>musculus frontalis dhe muskujt përreth syrit; -vizatimi i tyre</p> <p>5.3. Muskujt të mimikës: muskujt përreth hundës dhe vizatimi i tyre</p> <p>5.4. Muskujt të mimikës: -muskujt përreth gojës dhe vizatimi i tyre</p> <p>5.5. Vizatimi i muskujve të mimikës në tërësi</p> <p>5.6. Vizatimi i kokës anatomike përballë</p> <p>5.7. Vizatimi i kokës anatomike treçerek (gjysëmprofil)</p> <p>5.8. Vizatimi i kokës anatomike treçerek (gjysëmprofil)</p> <p>5.9. Vizatimi i kokës anatomike profil</p>	<p>muskuli për artistin;</p> <p>) shpjegon dhe vizaton formën e muskulit;</p> <p>) shpjegon dhe vizaton origjinën e muskulit;</p> <p>) shpjegon dhe vizaton kapjen e muskulit;</p> <p>) shpjegon lëvizjen e muskulit;</p> <p>) vizaton muskujt veç e veç dhe në grup sipas shtresave;</p> <p>) vizaton me forma të thjeshta gjeometrike kokën anatomike përballë, treçerek (gjysëmprofil) dhe profil.</p>	
Forma e kokës	<p>6.1. Studimi dhe vizatimi i syrit</p> <p>6.2. Studimi dhe vizatimi i profileve të hundës dhe të buzëve.</p> <p>6.3. Forma e veshëve dhe plastika e tyre. Ndryshimet e formës së flokëve sipas racave, moshave dhe seksit.</p> <p>6.4. Vizatimi i formës së kokës përballë, duke përcaktuar muskujt e dukshëm nën lëkurë</p> <p>6.5. Vizatimi i formës së kokës treçerek (gjysëmprofil), duke përcaktuar muskujt e dukshëm nën lëkurë</p> <p>6.6. Vizatimi i formës së kokës profil, duke përcaktuar muskujt e dukshëm nën lëkurë</p>	<p>) shpjegon dhe vizaton ndërtimin e syrit, veshit të jashtëm, profilet e hundës dhe buzën në pozicione të ndryshme duke nxjerrë në pah formën, vëllimin dhe pa prishur ndërtimin e tyre;</p> <p>) vizaton portretin duke u bazuar në format gjeometrike;</p> <p>) vizaton portretet sipas racave, moshave dhe seksit;</p> <p>) vizaton me dritë hije portretin duke përcaktuar muskujt e dukshëm nën lëkurë.</p>	<p>6 orë</p>
Skeleti i trungut	<p>7.1. Ndërtimi i përgjithshëm i columna vertebralis. Karakteristikat e vertebrave.</p> <p>7.2. Ndërtimi i vertebrae cervicales, ndryshimet ndërmjet tyre dhe vizatimi.</p> <p>7.3. Pars thoracalis dhe pars lumbalis dhe vizatimi i tyre</p> <p>7.4. Sacrum dhe coccygis</p> <p>7.5. Vizatimi i sacrum dhe coccygis</p>	<p>) shpjegon dhe vizaton pozicionin anatomik të çdo kocke, që i duhet artistit, në skeletin e trungut;</p> <p>) shpjegon dhe vizaton formën e columna vertebralis;</p> <p>) shpjegon rëndësinë e saj për artistin dhe regjionet e vertebrat që formojnë atë;</p> <p>) vizaton columna vertebralis në</p>	<p>8 orë</p>

	<p>7.6. Pamje e përgjithshme e columna vertebralis dhe vizatimi i saj në tri pamje: përballë</p> <p>7.7. Vizatimi i columna vertebralis profil dhe prapa</p> <p>7.8. Artikulacionet e columna vertebralis</p>	<p>përgjithësi dhe regjionet e saj në veçanti;</p> <p>) shpjegon rëndësinë e secilës kockë si bazë dhe pika kyçe në ndërtimin e regjionit të trungut të trupit të njeriut.</p>	
Toraksi (Thorax)	<p>8.1. Forma e përgjithshme e toraksit. Ndërtimi i brinjëve, ndryshimet ndërmjet tyre</p> <p>8.2. Vizatimi i brinjve</p> <p>8.3. Sternum dhe vizatimi i tij</p> <p>8.4. Artikulacionet e brinjve dhe vizatimi i tyre</p> <p>8.5. Thorax si i tërë, forma dhe ndërtimi</p> <p>8.6. Vizatimi i thorax-it</p>	<p>) shpjegon dhe vizaton ndërtimin e brinjëve, ndryshimet mes tyre ;</p> <p>) shpjegon dhe vizaton ndërtimin e sternum-it;</p> <p>) shpjegon ndërtimin e përgjithshëm të thorax dhe të artikulacioneve të tij;</p> <p>) vizaton bardh e zi dhe me ngjyra thorax në tri pozicione duke u bazuar në format gjeometrike.</p>	5 orë
Scapula dhe clavikula	<p>9.1. Scapula , forma dhe ndërtimi</p> <p>9.2. Vizatimi i scapula-s</p> <p>9.3. Clavicula, forma dhe ndërtimi</p> <p>9.4. Vizatimi i Clavicula-s</p>	<p>) shpjegon dhe vizaton ndërtimin e scapula-s;</p> <p>) shpjegon dhe vizaton ndërtimin e clavica-s .</p>	4 orë
Muskujt e qafës	<p>10.1. Muskujt e regjionit anësor dhe të përparmë të qafës</p> <p>10.2. Vizatimi i muskujve të qafës duke përdorur lapsa me ngjyra</p> <p>10.3. . Forma e jashtme e qafës</p> <p>10.4. Vizatimi i qafës, duke përcaktuar muskujt e dukshëm nën lëkurë</p>	<p>) shpjegon dhe vizaton pozicionin anatomik të çdo muskuli të mësuar në regjionin e qafës;</p> <p>) shpjegon rëndësinë e muskujve të qafës për artistin;</p> <p>) shpjegon dhe vizaton formën e muskujve më të rëndësishëm për artistin;</p> <p>) shpjegon dhe vizaton origjinën e muskulit;</p> <p>) shpjegon dhe vizaton kapjen e muskulit;</p> <p>) shpjegon lëvizjen e muskulit;</p> <p>) vizaton muskujt veç e veç dhe në grup sipas shtresave;</p> <p>) vizaton me dritë hije regjionin e qafës te nudo duke përcaktuar muskujt e dukshëm nën lëkurë.</p>	4 orë
	<p>11.1. Muskujt e shtresës sipërfaqësore të shpinës.</p> <p>11.2. Vizatimi i muskujve të shtresës sipërfaqësore të shpinës</p> <p>11.3. Muskujt e regjionit të</p>	<p>) shpjegon dhe vizaton pozicionin anatomik të çdo muskuli të mësuar në regjionin e shpinës;</p> <p>) shpjegon rëndësinë e çdo</p>	5 orë

<p>Muskujt e shpinës</p>	<p>zverkut 11.4. Vizatimi i muskujve regjionit të zverkut 11.5. Shtresa e thellë e muskujve të shpinës dhe vizatimi i tyre 11.6. Vizatimi i shpinës te nudo, duke përcaktuar muskujt e mësuar</p>	<p>muskuli për artistin; J shpjegon dhe vizaton formën e muskulit; J shpjegon dhe vizaton origjinën e muskulit; J shpjegon dhe vizaton kapjen e muskulit; J shpjegon lëvizjen e muskulit; J vizaton muskujt veç e veç dhe në grup sipas shtresave (e thellë apo sipërfaqësore); J vizaton me dritë -hije regjionin e shpinës te nudo duke përcaktuar muskujt e dukshëm nën lëkurë.</p>	
<p>Muskujt e kraharorit</p>	<p>12.1.Muskujt e regjionit të përparmë të kraharorit 12.2.Vizatimi i muskujve të regjionit të përparmë të kraharorit 12.3. Muskujt e regjionit anësor të kraharorit 12.4. Vizatimi i muskujve të regjionit anësor të kraharorit 12.5. Vizatimi i kraharorit te nudo (përballë dhe anash), duke përcaktuar muskujt e mësuar</p>	<p>J shpjegon dhe vizaton pozicionin anatomik të çdo muskuli të mësuar në regjionin e kraharorit; J shpjegon rëndësinë e çdo muskuli për artistin; J shpjegon dhe vizaton formën e muskulit; J shpjegon dhe vizaton origjinën e muskulit; J shpjegon dhe vizaton kapjen e muskulit; J shpjegon lëvizjen e muskulit; J vizaton muskujt veç e veç dhe në grup sipas shtresave (e thellë apo sipërfaqësore); J vizaton me dritë hije regjionin e kraharorit te nudo duke përcaktuar muskujt e dukshëm nën lëkurë.</p>	<p>4 orë</p>
<p>Muskujt e barkut</p>	<p>13.1.Muskujt e murit të përparmë dhe anësorë të barkut 13.2. Muskujt e murit të përparmë dhe anësorë të barkut 13.3.Muskujt e murit të përparmë dhe anësorë të barkut 13.4. Vizatimi i muskujve të murit të përparmë dhe anësorë të barkut 13.5. Vizatimi i muskujve të murit të përparmë dhe anësorë të barkut 13.6. Vizatimi i barkut te nudo, duke përcaktuar muskujt e dukshëm nën</p>	<p>J shpjegon dhe vizaton pozicionin anatomik të çdo muskuli të mësuar në regjionin e barkut; J shpjegon rëndësinë e çdo muskuli për artistin; J shpjegon dhe vizaton formën e muskulit; J shpjegon dhe vizaton origjinën e muskulit; J shpjegon dhe vizaton kapjen e muskulit; J shpjegon lëvizjen e muskulit; J vizaton muskujt veç e veç dhe në grup sipas shtresave (e thellë apo sipërfaqësore);</p>	<p>4 orë</p>

	lëkurë) vizaton me dritë hije regjionin e barkut te nudo duke përcaktuar muskujt e dukshëm nën lëkurë.	
--	--------	--	--

Dega: ART FIGURATIV
Specialiteti: Pikturë/Skulpturë
Lënda: Anatomi artistike
Klasa : 11-të
Kohëzgjatja: 34 javë x 2 orë/javë = 68 orë

1.Rezultatet e pritshme në fund të klasës së 11-të

Në përfundim të këtij programi, nxënësi/ja:

- njeh kockat që përmbajnë rrethin e anës së sipërme dhe skeletin e pjesës së lirë ;
- vizaton në tri pozicione kockat e gjymtyrës së sipërme ose të punoj me plastelin ato;
- njeh muskujt e gjymtyrës së sipërme, format, lidhjet dhe funksionin e tyre;
- vizaton ose punon me plastelin muskujt e gjymtyrës së sipërme;
- diskuton mbi ndërtimin kockor dhe muskulator të gjymtyrës së sipërme;
- njeh kockat e rrethit të gjymtyrëve të poshtme dhe skeletin të pjesës së lirë ;
- vizaton saktë kockat e gjymtyrës së poshtme, si dhe i punon ato me plastelin ;
- njeh muskujt e gjymtyrës së poshtme, format, lidhjet dhe funksionin e tyre;
- vizaton në tri pozicione gjymtyrën e poshtme, ose e punon atë me plastelin ;
- shpjegon dhe vizaton ndërtimin e trupit në tri pozicione, ose e punon atë me plastelin ;
- diskuton rreth ndryshimeve proporcionale të njëzë sipas moshave, si dhe i vizaton ato;
- vlerëson punën e vet dhe të shokut/shoqes si në anën teorike, ashtu edhe në anën profesionale - artistike.

2. Përmbajtja tematike e lëndës Anatomi artistike

Tematika	Tema mësimore	Rezultatet e pritshme	Orët
Gjymtyrë të sipërme “kockat e gjymtyrëve të sipërme”	1.1. Brezi i shpatullës: scapula dhe vizatimi i saj 1.2.Clavicula dhe vizatimi i saj 1.3.Skeleti i pjesës së lirë; skeleti i krahut (humerus) 1.4. Vizatimi i humerus-it 1.5.Skeleti i parakrahut: ulna, vizatimi i saj 1.6. Radius, vizatimi i tij 1.7. Skeleti i dorës 1.8. Vizatimi i skeletit të dorës 1.9.Vizatimi i skeletit të gjymtyrës së sipërme	<i>Nxënësi/ja:</i>) shpjegon dhe vizaton pozicionin anatomik të çdo kocke në gjymtyrën e sipërme;) shpjegon dhe vizaton pjesët e secilës kockë;) vizaton bardhëzi dhe me ngjyra kockat e gjymtyrës së sipërme.	8 orë
Artikulationet e gjymtyrës së sipërme	2.1. Artikulationet e gjymtyrës së sipërme dhe boshtet e lëvizshme të tyre 2.2.Artikulationet e gjymtyrës së sipërme dhe) shpjegon dhe vizaton pozicionin anatomik të çdo artikulationi të gjymtyrës së sipërme;) shpjegon dhe vizaton boshtet e	2 orë

	boshtet e l vizshm ris s tyre	<p>) lëvizshmërisë së tyre; vizaton ato bardh e zi dhe me ngjyra artikulacionet e gjymtyrës së sipërme.</p>	
Kohëzgjatja: 34 javë x 8 orë/javë = 272 orë

1.Rezultatet e pritshme

Në përfundim të këtij programi, nxënësi/ja:

-) realizon kompozimin e figurës së njeriut dhe me portretin në material;
-) përsos teknikat e gdhendjes;
-) trajton plastikisht dhe me stil materialin;
-) rrit ndjeshëm aftësinë e tij profesionale;
-) realizon karakterin psikologjik të portretit përveç karakterit vizual;
-) realizon figurën e njeriut në tërësi;
-) realizon me cilësi të gjitha detyrat, duke arritur nivelin profesional në realizimin e objekteve dekorative deri tek pjesë të figurës së njeriut;
-) komponon shume mirë në material dhe realizon mjeshtërisht dhe me stil shumë objekte dhe skulptura të kërkuara në treg si: *portret, kapitël, kolona, frize dekorative, rozeta dekorative* etj.

1.Përmbajtja tematike e lëndës Gdhendje guri dhe druri

Tematika	Tema mësimore	Rezultatet e pritshme	Orët
Medaljon portret në relief (krijim ose kopjim)	1.1.Realizimi i portretit relief ose alto relief i figurave historike dhe kulturore, kombinuar me shkrimin përkatës plotësuar dhe me simbolikën e figurës që trajton	<i>Nxënësi/ja:</i> <ul style="list-style-type: none">) realizon karakterin psikologjik dhe vizual të personazhit;) gdhend në mënyrë mjeshtërore materialin;) trajton nga ana plastike dhe estetike portretin. 	128 orë
Figurinë me motive popullore ose motive të ndryshme	2.1.Trajtimi i kostumeve popullore duke ruajtur masat volumore të kostumit origjinal, karakterin dhe dekorativitetin 2.2. Motive të ndryshme nga baleti, instrumentistë	<ul style="list-style-type: none">) rrit aftësitë kompozicionale në skulpturën e materialeve të forta;) tregon shkallën më të lartë të aftësive teknike dhe mjeshtërore;) trajton plastikisht dhe me stil materialin. 	144 orë

3.VLERËSIMI

Nxënësi/ja është i nivelit MJAFTUESHËM

Nxënësi/ja arrin këtë nivel, kur:



-) përdor me vështirësi teknikat e gdhendjes dhe ka mangësi në njohjen e karakteristikave të materialeve;
-) realizon dhe kompozon me vështirësi një objekt në material;
-) realizon me vështirësi hapat e punës që ndiqen në realizimin e detyrave të gdhendjes.

Nxënësi/ja është i nivelit MIRË

Nxënësi/ja arrin këtë nivel, kur:

-) përdor në nivel të kënaqshëm teknikat e gdhendjes dhe një mirë karakteristikat e materialeve;
-) realizon dhe kompozon në nivel të kënaqshëm një objekt apo figurën në material;
-) realizon mirë dhe me korrektësi hapat e punës që ndiqen në realizimin e detyrave të gdhendjes.

Nxënësi/ja është i nivelit SHUMË TË MIRË

Nxënësi/ja arrin këtë nivel, kur:

-) përdor në nivel shumë të mirë teknikat e gdhendjes dhe një mirë karakteristikat dhe mundësitë shprehëse të materialeve;
-) realizon dhe kompozon shumë mirë një objektet apo figurën në material;
-) realizon shumë mirë dhe me profesionalizëm hapat e punës që ndiqen në realizimin e detyrave të gdhendjes.

Dega: ART FIGURATIV - PIKTURË
Specialiteti: Grafikë
Klasa e: 10-të
Kohëzgjatja: 34 javë x 4 orë/javë = 136 orë

Shoqëritë bashkëkohore arsimin e konsiderojnë ndër pasuritë më të rëndësishme të njerëzimit dhe përpiqen të gjurmojnë potencialin e tij të plotë, në mënyrë që t'u ndihmojnë njerëzve të ballafaqohen me sfidat e botës së sotme. Procesi i këtij plan-programi synon rritjen e cilësisë së mësimdhënies në dimension profesional, të pajisur me dije, shprehje dhe vlera të shumëfishta. Ky program së bashku me ato të lëndëve të praktikave të ndryshme profesionale do të sigurojë formimin e nxënësve si një proces integral që përmbledh dimensionin e përgjithshëm të njeriut, dimensionin shoqëror dhe profesional. Qëllim kryesor I programit të lëndës është formimi i konceptit grafikë në përgjithësi, njohja me teknikat klasike të grafikës, si linogravura, ksilografia (gdhendja në dru), oforti, gjilpëra e thatë, monotipi, ashtu edhe grafikën në kompjuter, ku nxënësit mësojnë të përdorin software të standardizuara në industrinë e dizajnit, (paketa Adobe) si: photoshop, illustrator indesign, adobe acrobat etj, të nevojshme për realizimin e projekteve grafike për shtyp, ëeb dhe animacion. Nxënësit do mësojnë si të realizojnë projekte grafike të finalizuar për prodhim, duke u mundësuar atyre që ta shohin të gjithë procesin, nga koncepti fillestar deri në publikimin final. Disa nga temat që do trajtohen janë: dizajni, tipografia, përpunimi i imazheve, multimedia, programet kompjuterike, ilustrimi, reklama, historia e dizajnit.

Ndjekja e këtij programi (grafikë) në profilin mësimor Art figurativ, do të zhvillojë te nxënësit një tërësi kompetencash të cilat do ti shërbejnë atij për përvetësimin me efektivitet të programit mësimor, zhvillimin në nivelin e kërkuar të kompetencave profesionale dhe integrimin e mëtejshëm në shoqëri dhe në tregun e punës gjithnjë në ndryshim. Këto kompetenca të përgjithshme do të zhvillohen në një nivel më të lartë gjatë kryerjes së shkollimit për teknik figurativ, shkollimi 3- vjeçar.

Në përfundim të kësaj lënde nxënësi/ja:

- përdor burime dhe teknika të ndryshme (edhe ato të kompjuterizuara) të përmbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional;
- zbulon potencialin e tij të brendshëm për kërkim të vazhdueshëm në drejtim të zgjedhjeve të reja më efektive;
- të organizojë drejtë procesin e të nxënës, potencialin e tij kreativ dhe të shfaq gatishmërinë e vullnetin për një të nxënë që zgjat gjithë jetën;
- të mësojë të përdorë teknologjinë e përshtatshme për krijimin apo prezantimin e projekteve;
- të krijoj kompozime sipas detyrës së caktuar, të cilat të jenë të gatshme për shtyp
- të gjej dhe të përdor informacionin e duhur për detyrën, nga një shumëllojshmëri burimesh;
- të zgjidhë në mënyrë kreative probleme të kompozimit.

1.Rezultatet e pritshme

Në përfundim të këtij programi, nxënësi/ja:

-) zgjeron shprehitë për t'u pozicionuar në punën e tij drejt thellimit të disa veçantive (të rëndësishme këto për grafikën si gjini e artit pamor), siç janë koncepti grafik dhe gjuha sa më lakonike, e thjeshtëzuar;

-) merr njohuri teorike dhe praktike për llojet e shumta të grafikës;
-) klasifikon llojet e grafikës tradicionale, si: natyrën e qetë, peizazhin, portretin, figurën e kompozuar etj.;
-) zbaton disa nga teknikat kryesore të grafikës, si vizatimin grafik me penë dhe tush, karbon, penel të thatë etj.;
-) gdhend në ofort, linoleum dhe në dru;
-) shfrytëzon veçanti të grafikës si teknikë dhe si koncept, për t'i integruar në krijimet e artit pamor, duke i dhënë vizatimit dhe pikturës kuptim grafik;
-) angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional;
-) manifeston krijimtari, guxim, fantazi dhe praktikitet në kryerjen e këtyre detyrave;
-) respekton punën në grup, marrëdhëniet me mësuesin.

2.Përmbajtja tematike e lëndës Grafikë

Tematika	Tema mësimore	Rezultatet e pritshme	Orët
Organizimi i hapësirës	1.1. Grumbullimi i materialeve 1.2. Thjeshtëzimi dhe stilizimi 1.3. Kompozimi dhe lëvizja në kuadrat	<i>Nxënësi/ja:</i> <ul style="list-style-type: none">) aftësohet në paraqitjen e kompozicionin sipërfaqësor me anën e vijave;) paraqet variantin tonal të kompozicionit sipërfaqësor;) organizon variante koloristike të kompozicionit. 	32 orë
Elemente dheparime	2.1. Kompozimi. 2.2. Marrëdhënia objekt-sfond 2.3. Silueta 2.4. Raporti bardhë e zi 2.5. E përgjithshmja dhe detaji	<ul style="list-style-type: none">) Ka aftësi në organizimin e kompozicionit;) përvetëson në teknikë dhe material të grafikës;) përvetëson fenomenet e ngjyrës, teksturës dhe raportet ndërmjet tyre në konceptin grafikë. 	24 orë
Kompozim me disa elementë nga natyra	3.1. Përcaktimi i interierit 3.2. Ndarja e planeve vertikale-horizontale 3.3. Perspektiva 3.4. Ritmi dhe dekoracioni 3.5. E përgjithshmja 3.6. Detaji	<ul style="list-style-type: none">) vëren dallimet në fushën e të parit;) vëren cilësinë e perceptimeve vizuale;) dallon kontrastin si kusht të perceptimit të formave;) vëren prezencën e dritëhijes si kusht për nxitjen e sensacionit vizual. 	20 orë
Ushtrime krijuese (nga mendja)	4.1. Perceptimi i imazhit 4.2. Kompozimi dhe ndërtimi i imazhit (nga mendja) 4.3. Rishfaqja e imazhit 4.4. Vazhdimi i punës 4.5. E përgjithshmja dhe detaji	<ul style="list-style-type: none">) kupton kompozicionin si tërësi në hapësirë;) kupton hapësirën tre dimensionale;) bën organizimin e vlerave plastike;) kupton efektet e hije-dritës, të cilat përshkojnë tërësinë e përmbajtjes grafike. 	20 orë



Studime në natyrë	5.1. Njohja me detyrën 5.2. Dalja në natyrë 5.3. Veçimi i objekteve 5.4. Përpunimi grafik) analizon elementet e kompozicionit dhe të realizojë studime analitike të vijës dhe llojet e formave;) dallon raportet ndërmjet madhësive.	20 orë
Peizazh i realizuar në teknikën e monotypit	6.1. Zgjedhja e motivit 6.2. Kompozimi i fletës grafike 6.3. Hedhja në xham e ngjyrave 6.4. Shtypja e grafikës në letër) zgjedh motivin e përshtatshëm për teknikën e monotypit;) ndjek procedurën e saktë në hedhjen e monotypit;) kushton vëmendje realizimit të detyrës me të gjitha mjetet shprehëse që dikton lloji i teknikës;) zbaton me lirshmërishtypjen e grafikës në letër.	20 orë

3.VLERËSIMI

Nxënësi/ja është i nivelit SHUMË TË MIRË

Nxënësi/ja arrin këtë nivel, kur:

-) komponon në mënyrë të rregullt një objekt ose një grup objektesh në letër;
-) njeh konceptet bazë në trajtimin teorik dhe në ushtrimin praktik të zbërthimit grafik;
-) interpreton duke pasur të qartë konceptin grafik;
-) kupton ndryshimin midis mënyrës së ndërtimit të kontrastit në vizatim dhe grafikë;
-) është korrekt në zbatimin e programit dhe të detyrave të dhëna nga mësuesi i lëndës;
-) vlerëson nga ana teknike punën e tij dhe atë të tjerëve.

Nxënësi/ja është i nivelit MIRË

Nxënësi/ja arrin këtë nivel, kur:

-) komponon në mënyrë të mjaftueshme dhe relativisht mirë;
-) njeh disi konceptet bazë në trajtimin teorik dhe ushtrimin praktik të zbërthimit grafik;
-) interpreton duke pasur të qartë mjaftueshëm konceptin grafik;
-) kupton mjaftueshëm ndryshimin midis mënyrës së ndërtimit të kontrastit në vizatim dhe grafikë;
-) është relativisht korrekt me programin mësimor.

Nxënësi/ja është i nivelit MJAFTUESHËM

Nxënësi/ja arrin këtë nivel, kur:

-) komponon me defekte strukturore;
-) njeh pak koncepte bazë të zbërthimit grafik;
-) interpreton në mënyrë të përciptë konceptin grafik;
-) kupton me vështirësi ndryshimin midis mënyrës së ndërtimit të kontrastit në vizatim dhe grafikë;
-) ndjek jo rregullisht programin mësimor.

Dega: ART FIGURATIV - PIKTURË

Specialiteti: Grafikë

Klasa: 11-të

Kohëzgjatja: 34 javë x 6 orë/javë = 204 orë

1. Rezultatet e pritshme

Në përfundim të këtij programi, nxënësi/ja:

-) njeh teknikat e grafikës, si: linogravura, ksilografia (gdhendja në dru) oforti, gjilpëra e thatë, monotipi etj.;
-) thëllon konceptet grafike sipas llojit të teknikës që të imponon motivi i zgjedhur për t'u realizuar;
-) dallon që, për motive të caktuara, të zgjedhë teknikën dhe mjetet shprehëse më të përshtatshme për realizimin sa më cilësor të këtyre motiveve;
-) njeh teknikat e grafikës, si: gdhendja e ksilografisë dhe linografisë, incizimi i gjilpërës së thatë ose oforti, si dhe monotipi;
-) realizon shtypjen e secilës teknikë;
-) interpreton elementet dhe parimet e grafikës bazëtë ndërthurura me informatikën e specializuar;
-) njeh limitet e elementeve shprehëse të grafikës dhe të rritjes së pretendimeve artistike;
-) angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional;
-) manifeston krijimtari, guxim, fantazi dhe praktikitet në kryerjen e këtyre detyrave;
-) respekton punën në grup, marrëdhëniet me mësuesin.

2. Përmbajtja tematike e lëndës Grafikë

Tematika	Tema mësimore	Rezultatet e pritshme	Orët
Naturë e qetë e realizuar në teknikën e linogravurës	1.1. Zgjedhja e motivit 1.2. Kompozimi i fletës grafike 1.3. Hedhja në pllakën e linoleumit 1.4. Gdhendja e pllakës 1.5. Shtypja e grafikës në letër	<i>Nxënësi/ja:</i> <ul style="list-style-type: none">) krijon në përshtatshmëri motiv-technik;) njeh procedurën e hedhjes së motivit në pllakën e linoleumit;) kupton rëndësinë e veçantë të vlerave tonale, të vëllimit, të linjës dhe të efektit grafik në përgjithësi;) aftësohet në përdorimin e daltave në mënyre që të gdhend lirshëm linoleumin.	22 orë
Naturë e qetë e realizuar në teknikën e ksilografisë (gdhendje në dru)	2.1. Zgjedhja e motivit 2.2. Kompozimi i fletës grafike 2.3. Hedhja në pllakën e drurit 2.4. Gdhendja e pllakës 2.5. Shtypja e grafikës në	<ul style="list-style-type: none">) krijon përshtatshmëri motiv-technik;) ndjek procedurën e saktë; hedhja e natyrës së qetë nga letra e kalkut në pllakën e drurit;) dallon ndryshimin ndërmjet gdhendjes së linoleumit nga ajo	22 orë

	letër	<p>e drurit;</p> <p>) zbaton hapat për shtypjen e grafikës në letër dhe të dijë të shfrytëzojë veçoritë që ka pllaka e drurit;</p> <p>) kupton rëndësinë e veçantë që i jepet detajit dhe gjysmë tonit, meqenëse kjo teknikë e krijon më tepër këtë mundësi sesa teknika e linoleumit.</p>	
Natyrë e qetë e realizuar në teknikën e gjilpërës së thatë ose ofortit	<p>3.1. Zgjedhja e motivit</p> <p>3.2. Kompozimi i fletës grafike</p> <p>3.3. Hedhja në pllakën e zinkut</p> <p>3.4. Incizimi i pllakës së zinkut</p> <p>3.5. Shtypja e grafikës në letër</p>	<p>) përzgjedh motivin e përshtatshëm për teknikën e gjilpërës së thatë (ofortit);</p> <p>) ndjek procedurën e saktë të hedhjes së natyrës së qetë nga letra e kalkut në pllakën e zinkut, që incizohet dhe shtypet në letër;</p> <p>) kupton ndryshimin nga teknikat e tjera, kjo teknikë të jep mundësinë e dhënies së atmosferës, plemerit, sfumaturave dhe detajit të krijuar nëpërmjet linjës dhe tonalitetit që lë fshirja e pllakës nga boja e shtypit;</p> <p>) realizon detyrën me të gjitha mjetet shprehëse që i imponon lloji i teknikës.</p>	22 orë
Natyrë e qetë e realizuar në teknikën e monotipit	<p>4.1. Zgjedhja e motivit</p> <p>4.2. Kompozimi i fletës grafike</p> <p>4.3. Hedhja në xham e ngjyrave</p> <p>4.4. Shtypja e grafikës në letër</p>	<p>) punon në teknikën e shtypjes së letrës në xham, ku janë vendosur ngjyrat e shtypit;</p> <p>) zgjedh motivin e përshtatshëm për këtë teknikë;</p> <p>) realizon shumëllojshmërinë e tonaliteve, monokromatike ose kromatike, që kalojnë nga njëri-tjetri pa kufi ndarës.</p>	18 orë
Peizazh nga natyra i realizuar në teknikën e linogravurës	<p>5.1. Zgjedhja e motivit</p> <p>5.2. Kompozimi i fletës grafike</p> <p>5.3. Hedhja në pllakën e linoleumit</p> <p>5.4. Gdhendja e pllakës</p> <p>5.5. Shtypja e grafikës në letër</p>	<p>) bën zgjedhjen e përshtatshme për teknike e linoleumit;</p> <p>) gjen në natyrë këndin e shikimit sa më interesant dhe momentin kohor sa më grafik;</p> <p>) shfrytëzon planet, të seleksionojë objektet dhe ti stilizoj ato;</p> <p>) ndjek udhëzimet për të arritur këtë teknikë, që nga pika e pamjes, tek koncepti bardh e zi dhe në vazhdim me hedhjen e kalkut në linoleum, gdhendja dhe shtypi në letër.</p>	28 orë

<p>Peizazh i realizuar në teknikën e ksilografisë (gdhendjes në dru)</p>	<p>6.1. Zgjedhja e motivit 6.2. Kompozimi i fletës grafike 6.3. Hedhja në pllakën e drurit 6.4. Gdhendja e pllakës 6.5. Shtypja e grafikës në letër</p>	<p>) zgjedh motivin e përshtatshëm për teknikën e ksilografisë (gdhendje në dru);) ndjek procedurën e saktë pas hedhjes së peizazhit nga letra e kalkut në pllakën e drurit; gdhendet dhe shtypet në letër;) jep rëndësi detajit dhe gjysmë-tonit, meqenëse kjo teknikë e krijon më tepër këtë mundësi sesa pllaka e linoleumit;) gjen në natyrë këndin e shikimit sa më interesant dhe momentin kohor sa më grafik;) shfrytëzon planet, të seleksionojë objektet dhe ti stilizojë ato;) materializon objektet e shumëllojshme që ndodhen në natyrë.</p>	<p>28 orë</p>
<p>Peizazh i realizuar në teknikën e gjilpërës së thatë ose ofortit</p>	<p>7.1. Zgjedhja e motivit 7.2. Kompozimi i fletës grafike 7.3. Hedhja në pllakën e zinkut 7.4. Incizimi i pllakës së zinkut 7.5. Shtypja e grafikës në letër</p>	<p>) zgjedhë motivin e përshtatshëm për teknikën e gjilpërës së thatë ose fortit;) ndjek procedurën e saktë në hedhjen e peizazhit nga letra e kalkut tek pllaka e zinkut që incizohet dhe shtypet në letër;) demonstroi vëmendje realizimin e detyrës me të gjitha mjetet shprehëse që dikton lloji i teknikës;) demonstroi lirshmëri në incizimin me dalta çeliku e të realizojë një shtyp sa më të ngrohtë të pllakës së zinkut.</p>	<p>28 orë</p>
<p>Informatikë e specializuar.</p>	<p>8.1. Elementet e dizajnit grafik: - Linja, Forma, Hapësira, Ngjyra, - Përmasa, Paterni dhe Tekstura, - Tonaliteti 8.2. Parimet në dizajnin grafik: - Ekuilibri, Lëvizja, Uniteti, Ritmi, - Kontrasti, Theksimi.</p>	<p>) njih elementet e dizajnit grafik;) njih parimet e dizajnit grafik;) kupton aspektin më thelbësor të dizajnit grafik, unitetin, duke e arritur përmes parimeve si harmonia, ritmi, kontrasti, etj.;) njih emërtimin dhe ndërtimin e shkronjave;) klasifikon fontet;) njih parimet e kompozimit me germa;) shpjegon ngjyrën, kontrastin dhe vetitë psikologjike të natyrës;</p>	<p>36 orë</p>

) shpjegon ndjeshmëri ndaj ngjyrës si mënyrë për të arritur një komunikim pamor sa më efikas, si dhe për të diferencuar figurën nga sfondi.	
--	--	---	--

3.VLERËSIMI

Nxënësi/ja është i nivelit SHUMË TË MIRË

Nxënësi/ja arrin këtë nivel, kur:

-) përzgjedh me kompetencë motivin e duhur për teknikat e ndryshme grafike;
-) përvetëson karakteristikat bazë të teknikave të linoleumit, ksilografisë të gjilpërës së thatë dhe të dizajnit grafik, dhe është në gjendje që të riprodhojë në mënyrë sa më korrekte natyrën që e rrethon nëpërmjet këtyre teknikave;
-) dallon më së miri karakteristikat dhe mundësitë shprehëse të secilës teknikë;
-) tenton të drejtohet drejt një origjinaliteti dhe individualiteti personal (vetjak).

Nxënësi/ja është i nivelit MIRË

Nxënësi/ja arrin këtë nivel, kur:

-) përzgjedh motivin e duhur për teknikat e ndryshme grafike;
-) përvetëson mjaftueshëm karakteristikat bazë të teknikave të linoleumit, ksilografisë të gjilpërës së thatë dhe të dizajnit grafik, dhe është në gjendje që të riprodhojë në mënyrë sa më korrekte natyrën që e rrethon nëpërmjet këtyre teknikave;
-) dallon karakteristikat dhe mundësitë shprehëse të secilës teknikë.

Nxënësi/ja është i nivelit MJAFTUESHËM

Nxënësi/ja arrin këtë nivel, kur:

-) përzgjedh me vështirësi motivin e duhur për teknikat e ndryshme grafike;
-) njeh me vështirësi karakteristikat bazë të teknikave të linoleumit, ksilografisë, të gjilpërës së thatë dhe të dizajnit grafik, dhe nuk është në gjendje që të riprodhojë në mënyrë sa më korrekte natyrën që e rrethon nëpërmjet këtyre teknikave;
-) nuk arrin të dallojë karakteristikat dhe mundësitë shprehëse të secilës teknikë.

Dega: ART FIGURATIV - PIKTURË

Specialiteti: Grafikë

Klasa: 12-të

Kohëzgjatja: 34 javë x 8 orë/javë = 272 orë

1.Rezultatet e pritshme

Në përfundim të këtij programi, nxënësi/ja:

-) përqendron vëmendjen në aspektin kompozicional;
-) realizon ndërtimin e figurës sipas një koncepti të qartë grafik;
-) aftësohet drejt një vlere artistike-profesionale dhe teknike;
-) zgjedh temën e diplomës sipas dëshirës dhe aftësive të tij;
-) punon me koncept dhe projekt;
-) angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e diplomës në kontekstin profesional;
-) manifeston kreativitet, guxim, fantazi dhe praktikitet në kryerjen e diplomës;
-) respekton punën në grup, marrëdhënien me mësuesin.

2.Përmbajtja tematike e lëndës Grafikë

Tematika	Tema mësimore	Rezultatet e pritshme	Orët
Ngjyrat në grafikën figurative	1.1. Seleksionimi i detyrave të punuara më herët 1.2. Përgatitja e klishesë-sistemimi i palosjes së ngjyrave (një-ngjyrësh) 1.3. Sistemimi i palosjes së ngjyrave (dy, tre ngjyrësh)	<i>Nxënësi/ja:</i> J klasifikon llojet e ngjyrave që mund të realizojë grafika figurative dhe si të përdoren; J kryen punë përmes krijimit të grafikës një ngjyrësh (palosja); J kryen punë përmes krijimit të grafikës me dy dhe tre ngjyra (palosja).	22 orë
Portret nga natyra	2.1. Kompozimi i portretit 2.2. Raporti bardhë e zi 2.3. Detaji 2.4. E përgjithshmjia 2.5. Përfundimi i detyrës	J zgjedh portretin dhe ta vendosë në një pozicion, që të ketë kontrast sa më të qartë grafik, për ndarjen e dritë-hijes; J jep vëmendje ekspresivitetit të portretit, karakterit dhe gjendjes psikologjike që transmeton ai; J zgjedh një nga teknikat, sipas dëshirës, por ndarja grafike të jetë sa më e qartë, duke shmangur mundësisht gjysmëtonet; J realizon kompozimin e portretit dhe marrëdhënies së tij me sfondin.	30 orë
	3.1. Kompozimi i figurës	J përqendron vëmendjen në problemin kompozicional,	35 orë

Figurë njeriu e plotë	3.2. Hedhja e së përgjithshmes 3.3. Raporti bardhë e zi 3.4. Vizatimi i portretit 3.5. Vizatimi i duarve 3.6. Detaji 3.7. Përfundimi i detyrës dhe diskutimi rreth saj	si kërkesë themelore në këtë detyrë;) ndërton figurën sipas konceptit të qartë grafik, dhe ta realizojë me të gjitha mjetet shprehëse grafike, si në trajtimin bardhë e zi, ashtu edhe në atë me ngjyrë.) realizon variacionin në trajtimin e sipërfaqes.	
Figurë njeriu e plotë e realizuar në teknikë	4.1. Kompozimi i fletës grafike 4.2. Hedhja në pllakë (sipas teknikës së zgjedhur) 4.3. Gdhendja e pllakës 4.4. Shtypja e grafikës në letër) një parimet e kompozimit;) një gradacionin si ritëm;) kupton rëndësinë e veçantë të vlerave tonale, të vëllimit, të linjës dhe të efektit grafik në përgjithësi;	35 orë
Tipografi dhe kompozimi i faqes	5.1. Historia e tipografisë 5.2. Anatomia e shkronjave 5.3. Klasikimi fonteve 5.4. Rregullat e kompozimit 5.6. Theksi dhe hierarkia në tipografi 5.7. Njohje me hapësirën e punës 5.8. Krijimi i një dokumenti. Faqet udhëzuese 5.9. Përdorimi i kornizave. Kornizat e tekstit dhe kornizat grafike 5.10. Importimi dhe modifikimi i tekstit 5.11. Të punosh me ngjyrën 5.12. Stilet (stilet e paragrafit, stilete karakterit, stilet e objekteve, stilet e tabelave) 5.13. Importimi i imazheve 5.14. Krijimi i tabelave 5.15. Të punosh me transparencën dhe efektet 5.16. Të punosh me) një emërtimin dhe ndërtimin e shkronjave;) një klasifikimet e fonteve.) të njohë parimet e kompozimit me germa;) përdor mjetet, dritaret e dokumentit dhe panelet;) krijon një dokument të ri sipas përmasave të ndryshme. Të përdorë faqet udhëzuese dhe ti aplikoj ato;) krijon kornizat e ndryshme dhe të kuptojë ndryshimin midis tyre;) modifikon imazhin brenda kornizës;) shpërndan tekstin rreth një objekti;) punon me tekstin që rrjedh në disa korniza;) përdor ngjyrat dhe sfumaturat. Krijon ngjyra të sheshta(pantone);) krijon dhe aplikon stilet e objektit, tekstit, paragrafit dhe stilet e tabelave;) dallon imazhet vektoriale dhe ato bitmap;) shton imazhe me nivele nga photoshop dhe ilustrator;) përdor panelin e lidhjeve;) përdor adobe bridge.	30 orë

	dokumente të gjatë Krijimi i librit 5.17.Printimi dhe eksportimi në pdf) importon file pdf.	
6. Faqosja	6.1. Proporcione dhe gjeometri Skemat klasike, skemat me disa kollona, skema modulare) kupton nevojën dhe funksionin e përdorimit të skemave; J) njeh mënyrat antike të kompozimit; J) njeh skemat e kompozimit për publikime të ndryshme si libra, revista, gazeta, poster etj.	30 orë
5. Fletë grafike diplomë	5.1. Bisedë rreth diplomës 5.2. Njohja me projektin 5.3. Paraqitja e projektit 5.4. Punë e pavarur 5.5. Realizimi i diplomës) zgjedh gjininë dhe teknikën me të cilën do të përgatitet për projekt-diplomën; J) krijon një seri punimesh të përshkruara nga i njëjti koncept artistik dhe nga e njëjta ide dhe stilistikë; J) demonstroi punë sistematike për të shmangur dobësitë që dalin gjatë punës.	90 orë

3.VLERËSIMI

Nxënësi-ja është i nivelit SHUMË TË MIRË

Nxënësi/ja arrin këtë nivel, kur:

-) përzgjedh me kompetencë motivin e duhur për teknikat e ndryshme grafike;
-) përvetëson karakteristikat bazë të teknikave të linoleumit, ksilografisë e të gjilpërës;
-) riprodhon në mënyrë sa më korrekte natyrën që e rrethon nëpërmjet këtyre teknikave;
-) dallon më së miri karakteristikat dhe mundësitë shprehëse të secilës teknikë;
-) përpiqet të drejtohet drejt një origjinaliteti dhe individualiteti personal.

Nxënësi/ja është i nivelit MIRË

Nxënësi/ja arrin këtë nivel, kur:

-) përzgjedh motivin e duhur për teknikat e ndryshme grafike;
-) përvetëson mjaftueshëm karakteristikat bazë të teknikave të linoleumit, ksilografisë e të gjilpërës dhe është në gjendje që të riprodhojë në mënyrë sa më korrekte natyrën që e rrethon nëpërmjet këtyre teknikave;
-) dallon karakteristikat dhe mundësitë shprehëse të secilës teknikë.

Nxënësi/ja është i nivelit MJAF TUESHËM

Nxënësi/ja arrin këtë nivel, kur:

-) përzgjedh me vështirësi motivin e duhur për teknikat e ndryshme grafike;
-) njeh me vështirësi karakteristikat bazë të teknikave të linoleumit, ksilografisë e të gjilpërës dhe nuk është në gjendje që të riprodhojë në mënyrë sa më korrekte natyrën që e rrethon nëpërmjet këtyre teknikave;
-) nuk arrin të dallojë karakteristikat dhe mundësitë shprehëse të secilës teknikë.

Dega: ART FIGURATIV - PIKTURË
Specialiteti: Skenografi-kostumografi
Klasa: 10-të
Kohëzgjatja: 34 javë x 4 orë/javë = 136 orë

Lënda e skenografi-kostumografisë synon zhvillimin dhe evoluimin e prirjeve të nxënësve, zgjerimin e talentit dhe rritjen e aftësisë së perceptimit ndaj botës, në mënyrë objektive dhe subjektive. Duke u njohur fillimisht me teorinë bazë, teknikat, mjetet, konvencionin, e më pas duke rritur nivelin analitik, perceptimin e ngjarjes, hapësirës dhe kohës nxënësi arrin të përfundojë saktë një vepër skenike. Nxënësi në tre vite do të njohë procesin në zhvillim duke nisur me analizën e veprës dhe të karaktereve si dhe me periudhat e ndryshme artistike e social-ekonomike të veprave të dhëna. Do të njohë hapësirat e ndryshme skenike, do të kuptojë marrëdhëniet midis krijuesit dhe spektatorit, gjuhën skenike, mjetet teknike të nevojshme për realizimin e një evenimenti skenik. Ai do të kuptojë në tre vite me radhë përmasat, kalimet kohore, raportet midis aktorit dhe skenografisë, ndriçimit skenik dhe skenës, kostumeve dhe karakterit si dhe raportin midis skenografisë dhe kostumeve. Nëpërmjet detyrave të ndryshme praktike, që variojnë nga më thelbësoret dhe të thjeshtat e deri tek ato më të ndërlikuarat, më impenjativet; nëpërmjet shumëllojshmërisë teknike të përdorur gjatë tre viteve studim, nëpërmjet komunikimit profesional dhe ideor apo nëpërmjet njohurive shtesë për historinë e teatrit shqiptar dhe botëror dhe mbi të gjitha, duke përshtatur eksperiencat më në zë të shkollave botërore moderne, përveç synimit kryesor për të kanalizuar nxënësit në mënyrë progresive drejt perceptimit, eksplorimit dhe interpretimit të realitetit nëpërmjet artit, synimi tjetër është që të përgatisim një terren sa më prodhimtar dhe bazë për studimet e mëtejshme nëpër shkollat e larta, brenda dhe jashtë vendit.

1.Rezultatet e pritshme

Në përfundim të këtij programi, nxënësi/ja:

-) komponon në mënyrë të rregullt një objekt ose një grup objektesh në hapësirën skenike;
-) njeh konceptet bazë në trajtimin teorik dhe në ushtrimin praktik të zbërthimit të veprës;
-) perfeksionon elementet bazë dhe ato plotësuese, kombinimin e tyre, raportin piktorik, sipërfaqen skenike dhe rëndësinë e përmasës së saj në raport me një tjetër sipërfaqe, kontrastin koloristik, raportin e përmasave me aktorin;
-) praktikon, në fillim duke riprodhuar idenë e veprës dhe më pas duke e përshtatur idenë e tij pa humbur kërkesat e veprës;
-) analizon saktë idenë dhe konceptin e veprës;
-) punon saktë një vepër nga antikiteti grek;
-) punon me çdo detaj si objektet ashtu dhe teksturat në marrëdhënie me hapësirën skenike;
-) përvetëson veçoritë e periudhave të cilës i përket vepra;
-) njeh kushtet social-ekonomike dhe artistike të periudhës së antikitetit.

2.Përmbajtja tematike e lëndës Skenografi-Kostumografi

Tematika	Tema mësimore	Rezultatet e pritshme	Orët
	1.1.Skenografia dhe	Nxënësi/ja:	

Skenografia	llojet e saj 1.2. Historia mbi skenografinë) përvetëson njohuritë bazë mbi scenografinë;	4 orë
Kostumografia	2.1.Kostumografia dhe zhvillimi i saj 2.2.Të përbashkëtat dhe ndryshimet nga tekstili) dallon ndryshimet midis kostumit dhe tekstilit;	4orë
Pjesa teatrale	3.1.Pjesa teatrale: - drama, - tragjedia, - komedia, - baleti, - teatri i kukullave) kupton ndryshimet midis zhanreve të ndryshme të artit skenik;	4orë
Formati skenik	4.1. Format i skenik 4.2. Skica me formatin skenik) njeh formatin skenik dhe elementët përbërës të një skene, fondalin, rotativat, kuintat, bokaskena, arlekinët etj;	8orë
Kompozimi në formatin skenik	5.1. Kompozimi i objekteve të thjeshta në formatin skenik) krijon skica për kompozimin e elementeve 3 dimensionale (objekte skenike) në hapësirën skenike.	8orë
Mizanskena	6.1.Mizanskena 6.2.Lëvizja e personazheve në hapësirën skenike) njeh lëvizjet e aktorit;) ruan kompozimin e personazheve në hapësirën skenike.	4orë
Bufatoria	7.1. Butaforia 7.2.Ku dhe si përdoret) njeh elementët butaforikë;) kupton rolin dhe funksionin e tyre në skenografi.	4orë
Ndriçimi skenik	8.1. Ndriçimi skenik 8.2. Roli dhe funksioni i tij në skenë) njeh ndriçimin skenik, rëndësinë e tij në skenografi si edhe ndryshimin midis ndriçimit natyral dhe atij skenik;) ruan kompozimin e personazheve në hapësirën skenike.	4orë
Realizimi skenografik i një vepre	Vepra teatrale "Agamemnoni" Eskili 9.1. Njohja me pjesën teatrale, analizë e veprës dhe karaktereve. 8 orë 9.2.Grumbullimi i materialeve artistike dhe historike. 12 orë 9.3.Njohja me arkitekturën) praktikon në mënyrë efektive kërkimin për grumbullim material nga antikiteti grek;) njeh kushtet sociale- ekonomike dhe mënyrën e jetesës së grekëve të lashtë;) vlerëson drejt veshjet e	84orë

	antike greke 4 orë 9.4.Bisedë mbi trajtimin e kostumeve dhe personazheve. 4 orë 9.5.Hedhja e skicave të skenografisë . 8 orë 9.6.Hedhja e skicave të kostumografisë . 8 orë 9.7.Vendosja në ekuilibër skenik të elementëve skenike. 4 orë 9.8.Përshtatja e ndriçimit artistik në funksion të veprës. 4 orë 9.9.Hedhja në format të madh të skenografisë. 14 orë 9.10.Hedhja në format të madh të kostumografisë. 14orë 9.11.Mbyllja e detyrës. 4 orë	ndryshme sipas shkallës së hierarkisë;) njeh dhe të përvetëson konceptin e vendosjes së ekuilibrit midis elementëve të ndryshëm skenikë;) realizon me sukses skenografinë dhe kostumografinë në mënyrë origjinale.	
Maketi	10.1. Njohja me maketin 10.2. Studimi mbi maketin e një pjese teatrale	Kupton mënyrën dhe strukturën e një maketi skenik si një nga elementët kryesorë të realizimit të skenografisë.	12orë

3. VLERËSIMI

Nxënësi/ja është i nivelit MJAF TUESHËM

Nxënësi/ja arrin këtë nivel, kur:

-) komponon me defekte një objekt ose një grup objektesh në hapësirën skenike;
-) ka probleme me konceptet bazë në trajtimin teorik dhe në ushtrimin praktik të zërthimit të veprës;
-) nuk njeh parimet bazë të skenës dhe përmasat skenike;
-) nuk njeh raportet e skenës me aktorin dhe elementët teknikë të saj;
-) ka defekte të theksuara në analizimin e veprave të ndryshme dhe në mbledhjen e materialit shtesë.

Nxënësi/ja është i nivelit MIRË

Nxënësi/ja arrin këtë nivel, kur:

-) komponon mirë një objekt ose një grup objektesh në hapësirën skenike;
-) njeh mirë konceptet bazë në trajtimin teorik dhe në ushtrimin praktik të zërthimit të veprës;
-) njeh mirë dhe ka perfeksionuar parimet bazë të skenës dhe përmasat skenike;
-) njeh mirë raportet e skenës me aktorin dhe elementët teknikë të skenës;

-) analizon mirë karakteret e veprës dhe krijon njohuri të mira për periudhat e ndryshme në varësi të veprës së dhënë;
-) korrekt me programin mësimor.

Nxënësi/ja është i nivelit SHUMË TË MIRË

Nxënësi/ja arrin këtë nivel, kur:

-) komponon në mënyrë të rregullt një objekt ose një grup objektesh në hapësirën skenike;
-) njih saktë konceptet bazë në trajtimin teorik dhe në ushtrimin praktik të zbërthimit të veprës;
-) njih saktë dhe ka perfeksionuar parimet bazë të skenës si dhe përmasat skenike;
-) njih saktë raportet e skenës me aktorin si dhe elementët teknikë të saj;
-) analizon saktë karakteret e veprës dhe krijon njohuri shumë të mira për periudhat e ndryshme në varësi të veprës së dhënë;
-) është korrekt në zbatimin e programit dhe detyrat e dhëna nga mësuesi i lëndës.
-) vlerëson nga ana teknike punën e tij dhe atë të tjerëve.

Dega: ART FIGURATIV - PIKTURË
Specialiteti: Skenografi-kostumografi
Klasa: 11-të
Kohëzgjatja: 34 javë x 6 orë/javë = 204 orë

1.Rezultatet e pritshme

Në përfundim të këtij programi, nxënësi/ja:

-) punon saktë një maskë karnavale apo halloween;
-) punon me çdo detaj si objektet ashtu dhe teksturat në marrëdhënie me karakterin e maskës;
-) përvetëson veçoritë e teknikave për realizimin e maskës;
-) realizon skenografinë e një spektakli, koncerti, studio tv;
-) njeh skenografinë e spektaklit, format e ndryshme dhe ku mund të përdoret;
-) kupton ndryshimin midis skenografisë tv dhe asaj teatrale;
-) kupton rëndësinë që ka sot skenografia e spektaklit në kërkesat e publikut dhe në biznesin e medias;
-) përdor elementë skenikë sa më të kuptueshëm dhe të krijojë një skenografi sa më artistike dhe estetike;
-) kupton sa më mirë rëndësinë e ndriçimit si një lojë dritash që krijojnë gjendje emocionale të ndryshme;
-) punon saktë një vepër nga dramaturgjia shqiptare;
-) njeh kushtet social-ekonomike dhe artistike të Shqipërisë në atë periudhë;
-) identifikon ambientet karakteristike shqiptare;
-) demonstroi njohjen e fenomeneve jetësore të kohës dhe personazheve që e mbartin atë;
-) krijon një ambient sa më funksional të skenografisë;
-) drejtohet drejt një origjinaliteti dhe individualiteti personal në vazhdimësi të studimeve.

2.Përmbajtja tematike e lëndës Skenografi - Kostumografi

Tematika	Tema mësimore	Rezultatet e pritshme	Orët
Realizimi i maska karnavale ose halloween	1.1.Skicat për gjetjen e karakterit të maskës.6 orë 1.2. Bocetet me ngjyra të maskës.6 orë 1.3.Realizimi i maskës në baltë. Pozitivi.12 orë 1.4.Realizimi i negativit në allci. 6 orë 1.5.Derdhja e pozitivit të maskës. 6 orë 1.6.Pikturimi i maskës.6 orë Përpunimi i detajeve të maskës. Përfundimi i detyrës. 6 orë	Nxënësi/ja:) njuh dhe praktikon në mënyrë efektive gjetjen e karakterit të maskës;) njuh dhe praktikon ndërtimin e maskës në volum;) njuh dhe përvetëson teknikën e realizimit të negativit në allci;) realizon me sukses një maskë me të gjitha detajet e nevojshme.	48 orë
Realizimi iskenografisë së një spektakli, koncerti, studio TV	2.1.Teori për ndryshimet mes skenografisë teatrale dhe asaj televizive. 6 orë 2.2.Grumbullimi i materialeve artistike dhe konvencionale.6 orë 2.3. Hedhja e skicave të skenografisë.12 orë 2.4.Vendosja në ekuilibër të elementëve skenikë. 6 orë 2.5.Përshtatja e ndriçimit artistik në funksion të hapsirës skenike.6 orë 2.6.Hedhja në format të madh e skenografisë.12 orë 2.7.Përpunimi i detajeve bazuar në ndriçimin skenik.4 orë 2.8.Mbyllja e detyrës. 2 orë) njuh skenografinë e spektaklit, format e ndryshme dhe ku mund të përdoret ai;) dallon ndryshimin midis saj dhe skenografisë teatrale;) kupton rëndësinë që ka sot skenografia e spektaklit në kërkesat e publikut dhe në biznesin e medias.	54

<p>Komedi ose dramë shqiptare një deri në dy akte.</p>	<p>3.1.Njohja me veprat teatrale shqiptare. 10 orë</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Pas vdekjes,</i> - <i>Karnavalet e Korçës,</i> - <i>Gjenerali i ushtrisë së vdekur,</i> - <i>14 vjeç dhëndër,</i> - <i>Familja e peshkatarit</i> <p>3.2.Grumbullimi i materialeve artistike dhe historike. 14 orë</p> <p>3.3.Njohja me arkitekturën kombëtare shqiptare. 4 orë</p> <p>3.4.Përshtatje e pjesës me kohën në të cilën jetojnë personazhet. 4 orë</p> <p>3.5.Hedhja e skicave të skenografisë. 10 orë</p> <p>3.6.Hedhja e skicave të kostumografisë. 10 orë</p> <p>3.7.Vendosja në ekuilibër skenik të elementëve skenike. 5 orë</p> <p>3.8.Përshtatja e ndriçimit artistik në funksion të veprës. 5 orë</p> <p>3.9.Hedhja në format të madh të skenografisë. 15orë</p> <p>3.10. Hedhja në format të madh të kostumografisë. 15 orë</p> <p>3.11. Mbyllja e detyrës 10 orë</p>	<p>) njeh me intësi jetën, traditën, arkitekturën tradicionale shqiptare;</p> <p>) kupton kushtet e ndryshme shoqërore të zhvillimit të shoqërisë në kohën kur zhvillohet ngjarja e veprës teatrale apo letrare;</p> <p>) dallon ndryshimet e kostumografisë në bazë të zonave të ndryshme gjeografike, pamja e tyre në marrëdhënie me kohën si dhe karakteret e personazheve që i veshin ato;</p> <p>) integron njohuritë artistike me ato që ka nga lëndët e tjera mbi ndryshimet sociale-politike si dhe kushtet ekonomike të periudhave të ndryshme historike;</p> <p>) kupton përshtatjen e realitetit shqiptar në një skenografi dhe kostumografi të caktuar;</p> <p>) krijon drejt një zgjidhjeje skenike origjinale duke pasqyruar kështu një individualitet krijues të mirëfilltë.</p>	<p>102</p>
---	---	---	------------

3.VLERËSIMI

Nxënësi/ja është i nivelit MJAFTUESHËM

Nxënësi/ja arrin këtë nivel, kur:

-) kupton me vështirësi kërkesat ideore të veprës;
-) stilizon mjaftueshëm elementët skenikë;
-) skicon kostume pa marrë parasysh anën e tyre funksionale në përshtatje me personazhin e veprës;

-) përdor me vështirësi elementet kompozicional të veprës, duke mos arritur rezultatin e dëshiruar;
-) realizon pjesërisht aktet e veprës dhe ndriçimin e tyre;
-) ndjek jo-rregullisht programin mësimor.

Nxënësi/ja është i nivelit MIRË

Nxënësi/ja arrin këtë nivel, kur:

-) përvetëson mirë kërkesat ideore e konceptuale të veprës;
-) stilizon në mënyrë të kënaqshme elementët skenikë në marrëdhënie me periudhën për të cilën flet vepra;
-) krijon relativisht mirë kostumet e personazheve të veprës;
-) kompozon mirë objektet dhe elementët skenikë;
-) tenton drejt arritjes së harmonisë së ngjyrave në marrëdhënie me emocionin e veprës që realizohet;
-) realizon mirë të gjitha aktet e veprës dhe ndriçimin e tyre.

Nxënësi/ja është i nivelit SHUMË TË MIRË

Nxënësi/ja arrin këtë nivel, kur:

-) përvetëson saktë kërkesat ideore e konceptuale të veprës dhe analizon saktë gjuhën dramaturgjike të veprës;
-) stilizon saktë elementet skenike në marrëdhënie me periudhën për të cilën flet vepra;
-) krijon saktë kostumet e personazheve në varësi të periudhës për të cilën bën fjalë vepra;
-) kompozim saktë objektet dhe elementëve skenikë;
-) harmonizon raportin e ngjyrave me idenë dhe emocionin e veprës;
-) realizon saktë të gjitha aktet e veprës;
-) realizon saktë ndriçimin skenik të detyrës.

Dega: ART FIGURATIV - PIKTURË
Specialiteti: Skenografi-kostumografi
Klasa: 12-të
Sistemi: 3-vjeçar
Kohëzgjatja: 34 javë x 8 orë/javë = 272 orë

1. Rezultatet e pritshme

Në përfundim të këtij programi, nxënës/i,-ja:

-) realizon një vepër art-deko të një ambienti funksional;
-) kupton ndryshimin e një ambienti funksional art-deko kundrejt arkitekturës, skenës së teatrit dhe asaj tv;
-) stilizon objekte të përditshme si: karrige, tavolina, banakë, dritare, etj. në formë të tillë që të jenë sa më të veçanta dhe tërheqëse, pa prishur funksionalitetin e tyre;
-) njeh teatrin shekspirian, arkitekturën e asaj kohe, kostumet dhe objektet e saj;
-) perfeksionon konceptin e formës më konvencionale të realizimit skenik;
-) thjeshton realizimin skenik duke përdorur sa më pak elementë apo duke i stilizuar ato në funksion të idesë dhe konceptit.

2. Përmbajtja tematike e lëndës Skenografi – kostumografi

Tematika	Tema mësimore	Rezultatet e pritshme	Orët
Realizimi i ambientit të një lokali, restoranti, zyre, holli hoteli etj.	1.1. Teori për ndryshimet midis skenografisë së ambientit dhe asaj teatrale. 4 orë 1.2. Grumbullimi i materialeve artistike dhe konvencionale. 4 orë 1.3. Hedhja e skicave të arkitekturës së ambientit. 8 orë 1.4. Vendosja në ekuilibër e elementëve arkitektonikë. 8 orë 1.5. Përshtatja e ndriçimit artistik në funksion të hapësirës së ambientit. 8 orë 1.6. Hedhja në format të madh e ambientit arkitektonik. 8 orë 1.7. Përpunimi i detajeve bazuar në ndriçimin artistik dhe funksional. 4 orë 1.8. Mbyllja e detyrës. 4 orë	Nxënësi/ja:) kupton ndryshimin e arkitekturës kundrejt realizimit artistik të një ambienti arkitektonik;) stilizon objekte të përditshme si: karrige, tavolina, banakë, dritare, mure etj., në formë të tillë që të jenë sa më të veçanta dhe tërheqëse, siguri pa dëmtuar funksionalitetin e tyre.	100 orë

<p>Realizimi i skenografisë (3 akte) të një vepre të Shekspirit</p>	<p>2.1.Njohje me veprën, analiza e saj dhe personazheve. 10 orë 2.2.Grumbullimi i materialeve të kohës së cilës i përket vepra. 10 orë 2.3.Hedhja e skicave të skenografisë. 10 orë 2.4.Vendosja në ekuilibër skenik të elementëve skenikë. 4 orë 2.5.Përshtatja e ndriçimit artistik në funksion të hapësirës skenike. 4 orë 2.6.Skicat e kostumeve të personazheve. 10 orë 2.7.Hedhja në format të madh të skenografisë. 15 orë 2.8. Hedhja në format të madh të kostumografisë. 15 orë 2.9. Përpunimi i detajeve bazuar në ndriçimin skenik. 5 orë 2.10. Mbyllja e detyrës 5 orë</p>	<p>) njuh teatrin shekspirian;) njuh arkitekturën dhe kostumet e asaj kohe;) jep zgjidhje sa më të thjeshta në zgjidhjen e skenografisë duke përdorur sa më pak elementë skenikë apo duke i stilizuar ato në funksion të idesë dhe konceptit;) vendos në balancë skenografinë me kostumografinë pa krijuar kaos vizual në skenë;) përdor saktë ndriçimin në funksion të veprës duke krijuar situata të ndryshme ndriçimi në çdo akt.</p>	<p>88 orë</p>
--	--	---	---------------

<p>Komedi, dramë, tragjedi, (4 akte), spektakël, studio televizive</p> <p>Detyra e diplomës</p>	<p>3.1.Njohja me veprën dhe zbërthimi i saj</p> <p>3.2.Grumbullimi i materialit mbi periudhën kohore në të cilën zhvillohen ngjarjet si piktura, skulptura, arkitektura, kostumet etj.</p> <p>3.3.Skicat e skenografisë</p> <p>3.4.Skicat e kostumeve</p> <p>3.5. Bocetet me ngjyra të skenografisë</p> <p>3.6.Hedhja në format të madh të kostumeve</p> <p>3.7.Realizimi i maketeve ose i projektit 3 dimensional (në kompiuter) i diplomës</p> <p>3.8.Mbyllja e detyrës</p>	<p>) zgjedh dhe realizon saktë një pjesë teatrale (komedi, dramë, tragjedi, teatër kukullash, spektakël, studio televizive etj);</p> <p>) jep idenë e veprës;</p> <p>) krijon individualitetin e vet në zgjidhjen skenike dhe ta realizojë saktë atë;</p> <p>) krijon atmosferë të ndryshme ndriçimi në bazë të idesë si dhe të balancojë skenografinë me kostumografin;</p> <p>) realizon maketin e skenës përkatëse duke pasur parasysh arkitekturën e skenës dhe të jetë korrekt në proporcionet e elementeve skenikë.</p>	<p>84 orë</p>
---	---	---	---------------

VLERËSIMI

Nxënësi/ja është i nivelit MJAFTUESHËM

Nxënësi/ja arrin këtë nivel, kur:

-) analizon me defekte një vepër me katër akte;
-) përdor një gjuhë aspak lakonike;
-) përdor me vështirësi mjetet dhe elemente të ndryshëm të skenës;
-) përshtat me vështirësi raportet e ngjyrave në lidhje me konceptin e veprës skenike;
-) realizon me vështirësi një pjesë të maketit të veprës;

Nxënësi/ja është i nivelit MIRË

Nxënësi/ja arrin këtë nivel, kur:

-) analizon mirë një vepër me katër akte dhe përdor deri diku një gjuhë lakonike në funksion të konceptit të veprës;
-) përdor mirë elementet skenike dhe njeh mirë të gjithë pjesët përbërëse teknike të skenës;
-) përdor mesatarisht koloritin në varësi të emocionit të ngjarjes dhe materialet e ndryshme në skenografi dhe kostumografi në funksion të konceptit të veprës;
-) realizon mirë maketin e veprës;
-) realizon mirë të gjithë kërkesat e detyrës së diplomës.

Nxënësi/ja është i nivelit SHUMË TË MIRË

Nxënësi/ja arrin këtë nivel, kur:

-) analizon saktë një vepër me katër akte dhe përdor një gjuhë sa më lakonike në funksion të konceptit të veprës;
-) përdor saktë elementet skenike dhe njih mirë të gjithë pjesët përbërëse teknike të skenës;
-) përdor saktë koloritin në varësi të emocionit të ngjarjes dhe përdor më së miri materialet e ndryshme në skenografi dhe kostumografi në funksion të konceptit të veprës;
-) realizon saktë maketin e veprës;
-) realizon shumë mirë të gjitha kërkesat e detyrës së diplomës.

Dega: ARTI FIGURATIV - PIKTURË
Lënda: Tekstil dhe modë
Klasa: 10-të
Kohëzgjatja: 34 javë x 4 orë/javë = 136 orë

1. Rezultatet e pritshme

Në përfundim të këtij programi, nxënësi/ja:

-) merr njohuri në studimin dhe zhvillimin e historisë së artit popullor, kryesisht në punimet në tezgjah të tekstileve dhe veshjeve popullore tradicionale;
-) studion mirë natyrën dhe objektet e ndryshme që ndodhen, nëpërmjet vizatimit dhe stilizimit të tyre si me laps dhe me ngjyra;
-) kupton dhe krijon skema të ndryshme kompozicionale, kushtëzimet materiale, teknike, bifunksionaliteti dhe qëllimin e veprës nëpërmjet kopjimit të veprave të artit në tekstil dhe tapiceri të autorëve të ndryshëm;
-) krijon gjatë procesit krijues vetë kompozimin me ritëm të thjeshtë dhe kompozimin me ritëm asimetrik, duke dalluar ndryshimet e ritmit të kompozimit si në vizatim, zgjidhjen grafike dhe në realizimin me ngjyra;
-) punon i/e frymëzuar me dëshirë dhe fantazi krijuese në realizimin dhe mbylljen e detyrave me nivel sa më të lartë.

2. Përmbajtja tematike e lëndës Tekstil dhe Modë

Tematika	Tema mësimore	Rezultatet e pritshme	Orët
Njohja dhe studimi i artit popullorë, (Kopjime)	1.1. Njohja me teknika dhe materiale 1.2. Vizatimi, forma, ngjyra, toni, grafika, ritmi, simetria, asimetria, në tekstilet e ndryshme popullore 1.3. Stilizimi, abstrgimi dhe simbolika në artin popullorë	<i>Nxënësi/ja:</i> <ul style="list-style-type: none">) demonstroi gjatë punës së vet karakterin dallues në ndryshimin e qilimit me sixhaden, në teknikën e punimit dhe përdorimi i motiveve;) vizaton saktë modelin e qilimit në letër vizatimi, me anën e zmadhimit ose të zvogëlimit;) vazhdon punën me ngjyra deri në përfundim të projektit duke ndenjur besnik në modelin që kopjohet;) ruan karakterin e motiveve si në vizatim dhe me ngjyra;) ushtrohet në përdorimin e penelit dhe kombinimin e ngjyrave. 	20 orë
) realizon nga natyra vizatime me laps të zi dhe	20 orë

<p>Njohja dhe studimi i natyrës, (kryesisht floreale)</p>	<p>2.1. Vizatimi, pikturimi dhe stilizimi i motiveve dhe objekteve të zgjedhura në natyrë</p>	<p>me ngjyra, me pastele, akuarel etj.;</p> <ul style="list-style-type: none">) realizon vizatimet në kopshtin botanik: (lule, gjethe, pemë, flutura, zogj etj.) ;) realizon vizatimet në muzeun arkeologjik dhe historik vizatime të motiveve dhe objekteve të ndryshme ;) realizon vizatimet më të detajuara dhe të sakta si në linjë dhe me ngjyra dhe të larmishme në formë dhe ngjyra;) realizon vizatimet dhe realizimet me ngjyra të motiveve dhe objekteve të ndryshme;) stilizon dhe përpunon, për të realizuar sa më mire projektet e tekstit si dhe kompozime të ndryshme në këtë specialitet;) realizon ushtrime individuale, vizatime me laps dhe me ngjyra. 	
<p>Njohja me autor dhe vepra arti. Tekstil, tapiceri, (kopjime)</p>	<p>3.1 Kompozimi, 3.2. Trajtimi i kompozimit 3.3. Qëllimi i veprës së artit</p>	<ul style="list-style-type: none">) orientohet me skema dhe forma të ndryshme kompozicionale të realizuara në teknika dhe materiale të ndryshme;) zbaton kushtëzimet materiale dhe teknike, duke i shfrytëzuar ato në funksion artistik dhe estetik;) kupton bifunksionalitetin dhe qëllimin e veprës së artit që do të kopjohet;) zgjedh veprën e artit të një autori në tekstil, tapiceri, ose kompozim dekorativ;) kopjon kompoziminnë fillim duke e vizatuar në telajo, pastaj vazhdon puna duke e realizuar me ngjyra;) ruajnë karakterin e autorit 	<p>20 orë</p>

		në kopjimin e veprës së artit të tij.	
Kompozim me ritëm të thjeshtë	<p>4.1. Krijimi i kompozimit me dy ngjyra</p> <p>4.2. Krijimi i kompozimit me disa ngjyra</p>	<p>) krijon skema dhe forma të ndryshme kompozicionale, balancat koloristike dhe grafike;</p> <p>) përdor gjatë punëve tonet, ritmin, simetrinë, grafikën;</p> <p>) stilizon motivin e zgjedhur dhe bën përshtatjen e tij në projekt;</p> <p>) bën konceptimin paraprak të funksionit utilitar apo estetik të projektit që do krijohet;</p> <p>) krijon motivin në kompozim dhe e përsërit në mënyrë simetrike;</p> <p>) bën zgjedhjen e motivit, stilizimin dhe abstragimin në funksion të projektit;</p> <p>) kryen kërkim dhe jep zgjidhje e formës kompozicionale;</p> <p>) krijon bocete dhe zgjidhje grafike me ngjyra, variante të ndryshme;</p> <p>) përdor formatin në letër vizatimi 50x 35cm për realizimin e detyrës;</p> <p>) realizon me ngjyra dekorative dhe të vendosura në mënyrë simetrike.</p>	26 orë
Kompozim me ritëm asimetrik.	<p>5.1. Krijimi i kompozimit me dy ngjyra</p> <p>5.2. Krijimi i kompozimit me disa ngjyra</p>	<p>) kupton se skema kompozicionale e projektit është asimetrike si në formë dhe në ngjyra;</p> <p>) përdor tonet, ritmi, asimetria dhe zgjidhja grafike;</p> <p>) krijon kompozimin me disa ngjyra, skema kompozicionale, balanca koloristike, grafike dhe tonale;</p> <p>) bën konceptimin paraprak i funksionit utilitar apo estetik të projektit;</p>	30 orë

		<ul style="list-style-type: none">) zgjedh motivin, stilizimin dhe abstragimin në funksion të projektit;) kërkim dhe zgjidhje e formës kompozicionale;) bën bocete, zgjidhje grafike dhe me ngjyra, variante të ndryshme;) bën vizatimin e variantit më të mirë në letër vizatimi 50x 35cm;) realizon me ngjyra dekorative dhe të vendosura në mënyrë asimetrike. 	
Dizajnim për veshje, (fashion design)	<p>6.1.Njohja me veshjet tradicionale dhe me veshjet moderne të kohës që jetojmë</p> <p>6.2. Fantazi e lirë e nxënësve në dizajnin për veshje</p>	<ul style="list-style-type: none">) njeh veshjet popullore kombëtare, me larminë dhe dallimet e tyre sipas krahinave, seksit, moshave dhe funksionit që ato kanë;) njeh veshjet moderne (fashion design) të tipit altamoda, nëpërmjet katalogëve të ndryshëm, revistave të modës, skicave dhe vizatimeve të autorëve të ndryshëm etj.;) vizaton me lapsa me ngjyra dhe stilizim i një veshjeje me tendenca të spikatjes të disa elementeve tradicionalo - modern;) realizon në projektet për realizimin e veshjeve të ketë dallime në stilizimin veshjeve sipas stinëve dhe moshave;) krijon bocete dhe shumë variante të veshjeve të punuara me lapsa dhe me ngjyra për të realizuar një veshje të stilizuar në nivelin e dëshiruar;) zgjedh variantin më të mirë. Vizatimi dhe realizimi me ngjyra në 	20 orë

		letër në format më të madh;) bën ushtrime me fantazi të lirë dhe të pavarur jashtë mësimit.	
--	--	---	--

3. UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Mësuesi i lëndës Tekstil dhe modë duhet të njohë, të drejtojë e të nxisë veprimtarinë krijuese dhe realizuese të nxënësit. Kërkohet përgatitje dhe përgjegjësi maksimale për zbatimin me sukses të programit. Ai duhet të njohë mirë përmbajtjen e programit, si dhe të jetë vazhdimisht i interesuar për të kualifikuar veten në mënyrë individuale, të krijojë një bazë të fuqishme materiale për ti paraprirë zhvillimit normal të orëve të mësimit, të transmetojë qartë përmbajtjen e temës për detyrën e re të nxënësi.

Nxënësve u krijohet mundësia për të njohur e studiuar historinë dhe zhvillimin e artit popullor, historinë dhe zhvillimin e veshjes duke i parë të realizuara në muze të ndryshme dhe nëpërmjet librave, katalogëve me punime në tekstil dhe revistave. Gjithashtu nxënësi duhet të orientohet të frekuentojë ekspozitat e ndryshme të artit pamor, të bëjë vizita në galeri arti, muzeume dhe biblioteka duke shfrytëzuar librat e artit dhe katalogët në shërbim të temave dhe projekteve që do të realizojë. Ai në këtë mënyrë arrin të njohë autor dhe vepra në tekstil dhe tapiceri e më tej.

Njohja dhe studimi i natyrës realizohet duke dalë të organizuar në natyrë i gjithë grupi dhe me punë individuale jashtë shkollës. Realizohen sa më shumë vizatime me motive të ndryshme, me lule, gjethe, objekte të ndryshme nga arkeologjia, arkitektura etj. dhe çdo nxënës krijon bllokun e tij personal, i cili do ti shërbejë më pas për krijimin e projekteve sipas tematikës së caktuar nga programi. Këto vizatime stilizohen dhe përpunohen nga nxënësi në detaje në funksion të kompozimeve që do të realizojë.

4. VLERËSIMI

Në përfundim të çdo detyre, ekspozohen të gjitha projektet e nxënësve në atelie. Nxënësit duke qenë përballë punimeve diskutojnë dhe nxjerrin konkluzione për detyrat e tjera. Vlerësimi i nxënësit me notë do të bëhet në bazë të një diskutimi të lirë mbi arritjet dhe ato që nxënësi duhet të realizojë më mirë. Në diskutim marrin pjesë të gjithë nxënësit, të cilët orientohen nga mësuesi në bazë të objektivave të projektit të përfunduar. Në çdo përfundim detyre bëhen diskutime me nxënësit për mbylljen e detyrës dhe nxirren konkluzione për forma dhe arritje sa më të mira në nivelin realizues të punës. Në vlerësim do të merret parasysh edhe vetëvlerësimi i nxënësit, si dhe mendimi i shokut. Vlerësimi me notë bëhet në çdo përfundim detyre për të gjithë nxënësit. Vlerësimin me notën më të mirë e marrin nxënësit që krahas përfundimit të detyrës sipas kërkesave të programit realizojnë dhe detyra jashtë mësimit.

Nxënës/i,-ja është i nivelit të MJAFTUESHËM

-) Frekuenton orët e mësimit.
-) krijon dhe realizon mjaftueshëm.
-) realizon mjaftueshëm programin e mësimit.

Nxënës/i,-ja është i nivelit të MIRË

Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:

-) Frekuenton rregullisht orët e mësimit.
-) Realizon mirë programin mësimor.
-) Realizon mirë kompozimin në formë dhe përmbajtje.

Nxënës/i,-ja është i nivelit SHUMË TË MIRË

Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:

-) Frekuenton rregullisht orët e mësimit.
-) Realizon programin mësimor.
-) Realizon shumë mirë kompozimin si në formë dhe përmbajtje.

Dega: ARTI FIGURATIV - PIKTURË
Lënda: Tekstil dhe Modë
Klasa: 11-të
Kohëzgjatja: 34 javë x 6 orë/javë = 204 orë

Kjo lëndë ka për qëllim formimin artistik të nxënësit në drejtim të dizajnit industrial të tekstileve dhe pasurimin e ideve dhe formave kompozicionale në materiale të ndryshme dhe pikturën dekorative.

1.Rezultatet e pritshme

Në përfundim të këtij programi, nxënësi/ja:

-) të zhvillojë më tej njohuritë në studimin dhe zhvillimin e historisë të artit popullor, kryesisht në punimet e tekstilit dhe veshjet;
-) të përvetësojë sa më mirë stilizimin e elementeve, dekorativizimin e tyre, balancat grafike e koloristike, linjat, tonet, frakturat – si elemente stilizues;
-) të ketë njohuri teknike dhe artistike në realizimin e projekteve të dizajnit industrial dhe teknikave të tjera realizuese;
-) të zhvillojë dëshirën, fantazinë krijuese dhe realizuese në nivel sa më të mirë për përfundimin e projekteve gjatë vitit;
-) të ketë njohuri dhe arritje të mira me shije dhe fantazi personale në krijimin dhe realizimin e projekteve për veshje (fashion design);
-) të bëjë përpjekje dhe të njohë mirë kompozimin, të arrijë nivele të mira në krijimin dhe realizimin e kompozimit dekorativ dhe kolazhit.

2.Përmbajtja tematike e lëndës Tekstil dhe Modë

Tematika	Tema mësimore	Rezultatet e pritshme	Orët
Kompozim me ritëm gjeometrik.	1.1. Dizajnim për këmisha, mbulesa, veshje muri, shami të ndryshme etj.	<p><i>Nxënësi/ja:</i></p> <ul style="list-style-type: none">) kërkon skema dhe forma kompozicionale;) bën zgjidhje grafike të kompozimit;) bën baraspeshimin e linjave, toneve, ngjyrave dhe ruan ritmin si element parësor;) njeh procedurën e zbatimit teknik të projektit;) di destinacionin për të cilin krijohet projekti;) zgjedh motivin e përshtatshëm në shërbim të idesë, e vizaton atë, e stilizon dhe e abstragon duke e ruajtur simbolikën e vet;) realizon bocete, zgjidhje 	28 orë

		<p>grafike dhe me disa ngjyra, variante të ndryshme;</p> <p>) ka fantazi krijuese nëpërmjet bashkimit të motiveve;</p> <p>) realizon detyrën në formatin letër 50 x 35cm dhe e realizon me ngjyra.</p>	
Kompozim me ritëm asimetrik	2.1. Projekte për perde, mbulesa, copë metrazhi për veshje, veshje muri etj.	<p>) krijon skema dhe forma kompozicionale asimetrike;</p> <p>) kryen balanca grafike, koloristike, lineare etj.;</p> <p>) bën linja, tone, fraktura – si elemente stilizuese;</p> <p>) di destinacioni për të cilin krijohet projekti;</p> <p>) zgjedh motivin gjeometrik, floreal, oriental ose me objekte të ndryshme;</p> <p>) realizon vizatimin, stilizimin dhe abstragimin e tij;</p> <p>) krijon bocete, zgjidhje grafike dhe me ngjyra, nëdisa variante;</p> <p>) realizon vizatime, ku variantin më të mire e hedh në letër vizatimi me format të madh 50 x 35cm;</p> <p>) realizon me ngjyra projektin ku kërkohet në mënyrë sa më dekorative dhe mund të përdoren efekte të ndryshme gjatë realizimit.</p>	28 orë
Kompozim i mbyllur	3.1. Shami koke, shall, shami plazhi, shami të ndryshme etj.	<p>) realizon kompozim të mbyllur, që përbëhet nga qendra dhe bordurat;</p> <p>) realizon skema kompozicionale dhe forma që mund të zgjidhet simetrike ose asimetrike, në çdo rast i mbyllur;</p> <p>) trajton linja, tone, fraktura si elemente stilizues për ta pasuruar kompozimin;</p> <p>) krijon balancën si qendër – bordurë në vizatimin e motiveve dhe në koloritin e tyre mbi sipërfaqen e kompozimit;</p> <p>) zgjedh motivin ose objektin,</p>	38 orë

		<p>vizatimin, stilizimin dhe abstragimin e tyre në përshtatje të destinacionit;</p> <p>) krijon bocete, zgjidhje grafike dhe me ngjyra disa variante;</p> <p>) zbërthen motivin dhe krijon harmonizimin e tyre mes qendrës dhe bordurave;</p> <p>) realizon vizatimin e variantit më të mirë në letër vizatimi 50 x 50cm;</p> <p>) realizon me ngjyra në mënyrë dekorative.</p>	
Dizajnim për veshje, (fashion design)	<p>4.1. Njohuri fillestare të veshjes</p> <p>4.2. Fantazi e lirë e nxënësve në dizajnim për veshje</p> <p>4.3. Stilizimi duke u bazuar në veshjet tradicionale</p>	<p>) zhvillon tendencën për spikatje të elementeve tradicionale dhe moderne;</p> <p>) realizon stilizimin e figurës bashkë me veshjen;</p> <p>) bën dallimin në realizimin e veshjeve sipas stinëve dhe moshave;</p> <p>) bën krijimin dhe realizimin elegant të veshjeve nëpërmjet përdorimit të elementeve dhe mjeteve të ndryshme shprehëse;</p> <p>) bën zgjedhjen e veshjes që do të krijojmë;</p> <p>) mbledhjen e materialeve të ndryshme, foto nga veshjet popullore të zonës që njohim, vizatime, katalogë me veshje të modës, informacione të tjera për veshjet etj.;</p> <p>) realizon bocete me laps dhe me ngjyra, variante të ndryshme;</p> <p>) zgjedh variantin më të mirë dhe kryen realizimin në letër vizatim në formatin 70 x 50cm;</p> <p>) realizon ushtrime me fantazi të lirë dhe të pavarur jashtë mësimit.</p>	40 orë
Kompozim i	5.1. Perde, veshje,	<p>) zgjedh elementin –object dhe kryen stilizimin dhe abstragimin e tij;</p>	70

<p>lirë, (abtragim, kolazh)</p>	<p>veshje muri, zhakart, sixhade murale (gobelina), tapiceri etj. 5.2. Kompozim dekorativ duke përdorur edhe materiale të ngjitura në telajo apo sipërfaqe të tjera</p>	<ul style="list-style-type: none"> J bën dekorimin e elementeve të lojës kompozicionale; J trajton lojën artistike të elementeve të ndryshëm me gjuhë të lirë imagjinare gjatë një kompozimi; J realizon në telajo kompozimin në letër vizatimi ose edhe në material të tjera; J zgjedh motive simbolike dhe në përshtatje të kompozimit, mjeteve dhe materialeve që do të përdorim në këtë projekt; J realizon skema dhe forma kompozicionale, me zgjidhje sa më interesante që i shërbejnë njëra tjetrës; J realizon bocete, zgjidhje grafike dhe me ngjyra; J zgjedh variantin më të mirë dhe vizatimi në format të madh, në telajo, letër vizatimi apo materiale të tjera; J punon me prova dhe eksperimente artistike të rastësishme, gjatë realizimit me ngjyra, në procesin krijues; J zgjedh materialet që do të përdorë në kompozimin me kolazh, sa më simbolike dhe të zgjedhura mirë në shërbim të formës dhe përmbajtjes. 	
--	---	--	--

3. UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Mësuesi i lëndës Tekstil dhe Modë duhet të njohë, të drejtojë e të nxisë veprimtarinë krijuese dhe realizuese të nxënësit, kërkohet përgatitje dhe përgjegjësi maksimale për zbatimin me sukses të programit. Ai duhet të njohë mirë përmbajtjen e programit, si dhe të jetë vazhdimisht i interesuar për të kualifikuar veten në mënyrë individuale, të krijojë një bazë të fuqishme materiale për ti paraprirë zhvillimit normal të orëve të mësimit, të transmetojë qartë përmbajtjen e temës për detyrën e re të nxënësi.

Nxënësve u krijohet mundësia për të njohur e studiuar historinë dhe zhvillimin e artit popullor, historinë dhe zhvillimin e veshjes duke i parë të realizuara në muze të ndryshme

dhe nëpërmjet librave, katalogëve me punime në tekstil dhe revistave. Gjithashtu nxënësi duhet të orientohet të frekuentojë ekspozitat e ndryshme të artit pamor, të bëjë vizita në galeri arti, muzeume dhe biblioteka duke shfrytëzuar librat e artit dhe katalogët në shërbim të temave dhe projekteve që do të realizojë. Ai në këtë mënyrë arrin të njohë autor dhe vepra në tekstil dhe tapiceri e më tej.

Njohja dhe studimi i natyrës realizohet duke dalë të organizuar në natyrë i gjithë grupi dhe me punë individuale jashtë shkollës. Realizohen sa më shumë vizatime me motive të ndryshme, me lule, gjethe, objekte të ndryshme nga arkeologjia, arkitektura etj. dhe çdo nxënës krijon bllokun e tij personal, i cili do ti shërbejë më pas për krijimin e projekteve sipas tematikës së caktuar nga programi. Këto vizatime stilizohen dhe përpunohen nga nxënësi në detaje në funksion të kompozimeve që do të realizojë.

4. VLERËSIMI

Në përfundim të çdo detyre, ekspozohen të gjitha projektet e nxënësve në atelie. Nxënësit duke qenë përballë punimeve diskutojnë dhe nxjerrin konkluzione për detyrat e tjera. Vlerësimi i nxënësit me notë do të bëhet në bazë të një diskutimi të lirë mbi arritjet dhe ato që nxënësi duhet të realizojë më mirë. Në diskutim marrin pjesë të gjithë nxënësit, të cilët orientohen nga mësuesi në bazë të objektivave të projektit të përfunduar. Në çdo përfundim detyre bëhen diskutime me nxënësit për mbylljen e detyrës dhe nxirren konkluzione për forma dhe arritje sa më të mira në nivelin realizues të punës. Në vlerësim do të merret parasysh edhe vetëvlerësimi i nxënësit, si dhe mendimi i shokut. Vlerësimi me notë bëhet në çdo përfundim detyre për të gjithë nxënësit. Vlerësimin me notën më të mirë e marrin nxënësit që krahas përfundimit të detyrës sipas kërkesave të programit realizojnë dhe detyra jashtë mësimit.

Dega: ARTI FIGURATIV - PIKTURË
Lënda: Tekstil dhe Modë
Klasa: 12-të
Kohëzgjatja: 34 javë x 8 orë/javë = 272 orë

Programi i klasës 12-të ka për qëllim zhvillimin e mëtejshëm të njohurive të fituara në formimin artistik të nxënësit, në drejtim të projektimit industrial të tekstileve gjatë viteve, projekteve për stilizimin e veshjes, pasurimin e ideve dhe formave kompozicionale në materiale të ndryshme dhe pikturën dekorative, si dhe realizimin praktik të projektit në teknikën e qilimit dhe sixhadenë në tezgjah.

1.Rezultatet e pritshme

Në përfundim të këtij programi, nxënësi/ja:

-) të zhvillojë më tej njohuritë në studimin dhe zhvillimin e artit popullor, kryesisht në punimet e tekstit dhe veshjet;
-) të ketë njohuri teknike dhe artistike në realizimin e projekteve të dizajnit industrial dhe teknikave të tjera realizuese;
-) të krijojë dhe realizojë me stil dhe simbolikë personale në materiale të ndryshme projekte dhe kompozime në pikturën dekorative dhe kolazh, duke ja përshtatur arkitekturës bashkëkohore;
-) në krijimin e projekteve për veshje (fashion design) stilizimin, shijet dhe fantazinë personale ta realizojë në nivel më të mirë nëpërmjet projekteve dhe mundësive së realizimit në material të tyre;
-) të kenë njohuri praktike në realizimin e projekteve me material në tezgjah, në teknikën e thurjes dhe lidhjes me nyje për qilim dhe sixhade.

2.Përmbajtja tematike e lëndës Tekstil dhe Modë

Tematika	Tema mësimore	Rezultatet e pritshme	Orët
Kompozim abstrakt, (teknika të ndryshme)	1.1. Pikturë dekorative murale, e stilizuar dhe e abstraguar 1.2. Teknika të ndryshme mbi kanavacë dhe kolazh me materiale të ndryshme	<i>Nxënësi/ja:</i>) zgjedh objektin, stilizon dhe bën abstragimin e tij në nivele simbolike;) realizon zgjidhjen grafike të kompozimit;) realizon barazpeshimine linjave, toneve dhe ngjyrave;) realizon lojën vizive të elementeve të abstraguara;) bën orientimin për krijimin dhe avancimin e stilit dhe simbolikës personale;) zgjedh motivin - objektin të përshtatshëm në shërbim të idesë;) realizon vizatimin, stilizimin dhe	44 orë

		<p>abstragimin e motiveve dhe objekteve;</p> <p>) realizon bocete, zgjidhje grafike dhe me ngjyra, forma të ndryshme kompozicionale, variante me ngjyra;</p> <p>) realizon vizatimin në telajo ose në materiale të tjera në format të madh;</p> <p>) kryen realizimin e kompozimit me ngjyra dhe me materiale e teknika të ndryshme.</p>	
Kompozim i mbyllur apo i hapur, (thurje, lidhje, stampim)	2.1. Dizajnim për çarçafë, kuvertë, jastëkë, sofrabeze, peceta etj.	<p>) realizon lojën me tone të përafërta, gama koloristike, finesa lineare;</p> <p>) kryen zgjedhje të posaçme të motiveve për krijimin e emocioneve të qetësisë dhe të rehatisë;</p> <p>) realizon tendencë dhe finesë elegante kompozicionale;</p> <p>) zgjedh motivin, stilizimin dhe abstragimin në një kompozim;</p> <p>) realizon balancimin në kompozimin e qendrës me bordurat, gjithashtu dhe ngjyrat, tonet, linjat etj.;</p> <p>) realizon bocete, zgjidhje grafike dhe me ngjyra, në variante të ndryshme;</p> <p>) realizon përpunimin e gamës koloristike, përmes përdorimit të ngjyrave të qeta dhe dekorative;</p> <p>) realizon vizatimin në format të madh dhe bën vlerësim nëpërmjet kompozimit të motiveve dhe shpërndarjes së tyre në qendër dhe në bordurë;</p> <p>) kryen realizimin me ngjyra të projektit përmes një pune të pastër dhe me gama të përafërta në mënyrë sa më dekorative dhe trajtimi i saktë dhe dekorativ i motiveve.</p>	44 orë
Thellim në	3.1. Projekte për shtroje, qilim, sixhade, tapet	<p>) realizon zgjedhjen e motiveve në përshtatje të teknikës së punimit me fije leshi në tezgjah;</p> <p>) përqendrohet në stilizimin dhe ritmin e motiveve të shpërndarë</p>	56 orë

kompozimin e mbyllur,(thurje, lidhje)		<p>në sipërfaqen e kompozimit;</p> <p>) kryen harmonizimin e hapësirave të sfondit e të motiveve dhe qendrën me bordurat;</p> <p>) realizon linja, tone, fraktura – si elemente stilizues;</p> <p>) realizon balanca grafike e koloristike, me organizim qendër – bordurë si në vizatimin e motiveve dhe në koloritin e tyre mbi sipërfaqen e kompozimit;</p> <p>) përdor shumëllojshmëri të mjeteve shprehëse në realizimin e projektit;</p> <p>) zgjedh motivin qendror të bordurave, stilizimin, abstragimin dhe përpunimin;</p> <p>) zhvillon trajtimin dhe pasurimin e formës kompozicionale;</p> <p>) realizon bocete, zgjidhje grafike dhe me ngjyra disa variante;</p> <p>) realizon zbërthimin e motivit dhe kryen harmonizimi i tyre mes qendrës dhe bordurave;</p> <p>) realizon vizatimin e variantit më të mire në letër vizatimi 70 x 50cm;</p> <p>) kryen realizimin me ngjyra dekorative, harmonike dhe të shtrira.</p>	
Kompozim me elemente simbolikë (diplomë)	<p>4.1. Kompozim në teknikën e thurje – lidhjes për qilim, sixhade murale (gobelina)</p> <p>4.3. Pikturë dekorative murale, në fasada të brendshme</p> <p>4.3. Teknika të ndryshme mbi kanavacë</p>	<p>) zgjedh motivin si objekt – në nivelin simbolik;</p> <p>) kupton se forma dhe përmbajtja duhet të shërbejnë dhe të jenë në funksion të kompozimit;</p> <p>) përdor lojën vizive të elementeve të abstraguara;</p> <p>) orientohet për krijimin dhe avancimin e stilit dhe simbolikës personale nëpërmjet pikturimit dhe realizimit të projektit;</p> <p>) përdor mjete të ndryshme shprehëse në kompozim;</p> <p>) realizon stilizimi dhe abstragimi i motiveve dhe objekteve në nivelin simbolik;</p> <p>) realizon bocete, zgjidhje grafike, me laps dhe me ngjyra, variante</p>	<p>72 orë</p>

		<p>të ndryshme;</p> <ul style="list-style-type: none">) realizon vizatimin e saktë të gjitha detajeve të kompozimit në telajo;) realizon mbushjen e sfondit me ngjyra, dhe mbushjen e motiveve dhe objekteve me ngjyra;) realizon trajtimin artistik dhe të detajeve të ndryshme të kompozimit në të gjithë sipërfaqen e telajos;) përdor forma, mjete dhe materiale të ndryshme në realizimin përfundimtar të kompozimit. 	
Dizajnim për veshje, (fashion design)	<p>5.1. Fantazi e lirë në dizajnimin për veshje</p> <p>5.2. Stilizimi i veshjeve duke u mbështetur dhe duke marrë elementë të ndryshëm nga veshjet tradicionale shqiptare ku ne i njohim ato më mirë</p>	<ul style="list-style-type: none">) zhvillon njohuritë, shijet dhe fantazinë personale;) realizon krijim të veshjeve të tipit altamoda;) shfrytëzon elemente nga veshjet kombëtare për të stilizuar duke i lehtësuar në përafrimin e frymës me veshjet e kohës;) spikat gjatë punimeve me elemente tradicionale dhe moderne;) realizon veshje me ngjyra ose edhe me materiale të ndryshme;) realizon bocete me laps, zgjidhje grafike dhe me ngjyra, variante të ndryshme;) shfrytëzon materialet të ndryshme katalogë, revista të modës, ekspozita të ndryshme etj;) realizon vizatim në format të madh, realizim me ngjyra dhe me material të tjera;) realizon veshje në manekin me materiale të ndryshme;) kryen ushtrime me fantazi të lirë dhe të pavarur jashtë mësimit. 	56 orë

3. UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Mësuesi i lëndës Tekstil dhe Modë duhet të njohë, të drejtojë e të nxisë veprimtarinë krijuese dhe realizuese të nxënësit, kërkohet përgatitje dhe përgjegjësi maksimale për zbatimin me sukses të programit. Ai duhet të njohë mirë përmbajtjen e programit, si dhe të jetë

vazhdimisht i interesuar për të kualifikuar veten në mënyrë individuale, të krijojë një bazë të fuqishme materiale për ti paraprirë zhvillimit normal të orëve të mësimit, të transmetojë qartë përmbajtjen e temës për detyrën e re të nxënësi.

Nxënësve u krijohet mundësia për të njohur e studiuar historinë dhe zhvillimin e artit popullor, historinë dhe zhvillimin e veshjes duke i parë të realizuara në muze të ndryshme dhe nëpërmjet librave, katalogëve me punime në tekstil dhe revistave. Gjithashtu nxënësi duhet të orientohet të frekuentojë ekspozitat e ndryshme të artit pamor, të bëjë vizita në galeri arti, muze dhe biblioteka duke shfrytëzuar librat e artit dhe katalogët në shërbim të temave dhe projekteve që do të realizojë. Ai në këtë mënyrë arrin të njohë autor dhe vepra në tekstil dhe tapiceri e më tej.

Njohja dhe studimi i natyrës realizohet duke dalë të organizuar në natyrë i gjithë grupi dhe me punë individuale jashtë shkollës. Realizohen sa më shumë vizatime me motive të ndryshme, me lule, gjethe, objekte të ndryshme nga arkeologjia, arkitektura etj. dhe çdo nxënës krijon bllokun e tij personal, i cili do ti shërbejë më pas për krijimin e projekteve sipas tematikës së caktuar nga programi. Këto vizatime stilizohen dhe përpunohen nga nxënësi në detaje në funksion të kompozimeve që do të realizojë.

4. VLERËSIMI

Në përfundim të çdo detyre, ekspozohen të gjitha projektet e nxënësve në atelie. Nxënësit duke qenë përballë punimeve diskutojnë dhe nxjerrin konkluzione për detyrat e tjera. Vlerësimi i nxënësit me notë do të bëhet në bazë të një diskutimi të lirë mbi arritjet dhe ato që nxënësi duhet të realizojë më mirë. Në diskutim marrin pjesë të gjithë nxënësit, të cilët orientohen nga mësuesi në bazë të objektivave të projektit të përfunduar. Në çdo përfundim detyre bëhen diskutime me nxënësit për mbylljen e detyrës dhe nxirren konkluzione për forma dhe arritje sa më të mira në nivelin realizues të punës. Në vlerësim do të merret parasysh edhe vetëvlerësimi i nxënësit, si dhe mendimi i shokut. Vlerësimi me notë bëhet në çdo përfundim detyre për të gjithë nxënësit. Vlerësimin me notën më të mirë e marrin nxënësit që krahas përfundimit të detyrës sipas kërkesave të programit realizojnë dhe detyra jashtë mësimit.

Dega: ARTI FIGURATIV - PIKTURË
Specialiteti: Fotografi
Klasa: 10-të
Kohëzgjatja: 34 javë x 4 orë/javë = 136 orë

Lënda e fotografisë synon të njohë nxënësit me teknikat e fotografisë dhe t'i aftësojë ata në përdorimin e aparatit dhe aksesorëve që shërbejnë për procesin e krijimit në fotografi. Programi synon gjithashtu t'i bëjë nxënësit të vëmendshëm ndaj mediumit të fotografisë jo vetëm si një shkencë por dhe si një mjet për tu shprehur në kontekstin kulturor. Mjeshtëria në teknikën e fotografisë dhe evoluimi në principet artistike të mediumit, janë faktorët që do ta udhëheqin nxënësin në krijimin e personalitetit artistik të tij. Në përfundim të këtij programi nxënësi do të jetë i aftë të krijojë një portofol të plotë me krijimtaritë e tij të cilat do të shfaqin njohuritë e përfituara si dhe do ti shërbejnë atij në studimet e mëpasme.

1.Rezultatet e pritshme

Në përfundim të këtij programi, nxënësi/ja:

-) përvetëson mirë elementet teorike, teknike dhe artistike që luan fotografia;
-) përvetëson mirë teknikat e fotografimit: kompozim, këndvështrim;
-) njeh mirë ndërtimin e aparatit dhe pjesët përbërëse të tij;
-) njeh mirë funksionin që luajnë objektivat dhe diafragma;
-) njeh mirë materialet negative dhe pozitive;
-) përvetëson teknologjinë e re të fotografimit, të njihet me aparatit digjital;
-) përsoset në fushën e kompozimit të modelit, peizazhit, natyrë e qetë.

2.Përmbajtja tematike e lëndës Fotografi

Tematika	Tema mësimore	Rezultatet e pritshme	Orët
Fotografia dhe historiku i saj	1.1 Fotografia	<i>Nxënësi/ja:</i>) njeh artin e fotografisë;) njeh fotografinë botërore;) njeh fotografinë dhe autorët shqiptarë;) njeh zhanret e ndryshme të artit të fotografisë.	30 orë
	1.2 Historiku i fotografisë		
	1.3 Njohje me fotografinë shqiptare		
	1.4 Zhanret e fotografisë		
Njohje me teknikën e fotografisë	2.1.Ndërtimi i filmit bardhë e zi) kupton ndërtimin e filmit bardhë e zi dhe me ngjyra;) dallon elementet që përbëjnë filmin;) përshkruan ndërtimin dhe funksionimin e aparatit me film si dhe manual;) praktikohet me programet automatike;) krijon një set fotografik me objekte të thjeshta.	30 orë
	2.2.Ndërtimi i filmit me ngjyra		
	2.3.Ndërtimi i aparatit fotografik me film		
	2.4.Ndërtimi i aparatit fotografik digjital		
	2.5.Pjesët e aparatit fotografik		
	2.6.Programet automatike		
	2.7.Detyrë praktike me objekte të thjeshta. Natyrë e qetë		

Krijueshmëria në fotografi	3.1 Programi manual. 3.2 Apertura (diafragma) dhe përdorimi i saj 3.3 ISO (ndjeshmëria e filmit ose e sensorit) dhe përdorimi i tij 3.4. Shutter speed (grila e dritës) dhe si përdoret 3.5.Detyrë praktike natyrë e qetë) zbaton udhëzimet e programit manual;) kupton dhe përdor gjatë fotografimit aperturën;) krijon foto duke përdorur ISO-n;) përdor gjatë krijimit të fotove grilën e dritës për të krijuar efekte;) krijon punë të ndryshme duke përdorur njohuritë e marra për të qenit krijues;	26 orë
Elementët e kompozimit	4.1.Njohuri bazë mbi kompozimin e kuadrit 4.2.Llojet e planeve: detaji, portret, bust etj. 4.3.Pika e kuadrimin (point of view) 4.4.Thjeshtësia në kuadër 4.5.Loja me format gjeometrike në kuadër 4.4. Balancimi i kuadrit 4.5.Prerja e qëllimshme e kuadrit dhe elementeve në të 4.6. Thellësia e kuadrit 4.7. Rregulli i 1/3 në kuadër 4.8. Thyerja e rregullave në kompozimin e kuadrit 4.9. Detyrë praktike me objekte më komplekse Natyrë e qetë) realizon kompozimin e kuadrit;) kupton prerjet e planeve.) praktikon pikën e kundrimin;) realizon dhe është krijues me elementet më komplekse që ndërtojnë fotografinë;) realizon një set fotografik natyrë e qetë me objekte komplekse.	50 orë
Fotografia e peizazhit urban	5.1 Loja me perspektivën dhe rëndësia e saj në kuadër 5.2. Loja me dritën dhe si ta kërkojmë 5.3. Loja me planet për një kuadër sa më të thellë. Objektet e planit të parë, të dytë, etj. 5.4. Loja me shutter speed për një fotografi sa më dinamike) kupton rolin dhe funksionin e perspektivës si dhe rëndësinë e saj në kuadër;) kupton rëndësinë e dritës natyrale dhe ta kërkojë atë;) ndërton një kuadër sa më të thellë duke luajtur me planet.) krijon një kuadër sa më dinamik urban.	

3.VLERËSIMI

Nxënësi/ja është i nivelit MJAFTUESHËM

Nxënësi/ja arrin këtë nivel, kur:

-) njeh minimalisht ndërtimin e aparatit dhe elementët përbërës të tij;
-) njeh minimalisht ndërtimin e filmit negativ dhe pozitiv;
-) njeh pak funksionimin e aparateve digjitale;
-) kryen të paktën një detyrë praktike të dhënë gjatë vitit.

Nxënësi/ja është i nivelit të MIRË

Nxënësi/ja arrin këtë nivel, kur:

-) përvetëson mesatarisht elementet teorike, teknike dhe artistike që luan fotografia;
-) përvetëson mesatarisht elementet e kompozimit dhe këndvështrimit;
-) përvetëson mirë ndërtimin e aparatit dhe elementët përbërës të tij;
-) njeh mirë funksionimin e aparateve digjitale;
-) kryen pjesërisht detyrat praktike të dhëna gjatë vitit.

Nxënësi/ja është i nivelit SHUMË TË MIRË

Nxënësi/ja arrin këtë nivel, kur:

-) përvetëson elementet teorike, teknike dhe artistike që luan fotografia;
-) përvetëson dhe krijon në mënyrë të saktë elementete kompozimit dhe këndvështrimit;
-) njeh profesionalisht ndërtimin e aparatit dhe elementët përbërës të tij;
-) njeh mirë rolin që luajnë objektivat dhe diafragma;
-) përvetëson ndërtimin e filmit negativ dhe pozitiv;
-) njeh më së miri funksionimin e aparateve digjitale;
-) kryen me sukses detyrat praktike të dhëna gjatë vitit.

Dega: ARTI FIGURATIV - PIKTURË
Specialiteti: Fotografi
Klasa: 11-të
Kohëzgjatja: 34 javë x 6 orë/javë = 204 orë

1. Rezultatet e pritshme

Në përfundim të këtij programi, nxënësi/ja:

-) njeh saktë objektivat dhe ndërtimin e tyre;
-) praktikon dhe krijon foto me objektivat këndgjerë;
-) praktikon dhe krijon foto me objektivat me kënd normal;
-) praktikon dhe krijon foto me objektivat këndngushtë;
-) njeh pajisjet teknike të ndriçimit;
-) praktikon dhe krijon foto me ndriçim natyral;
-) praktikon dhe krijon foto me ndriçim artificial;
-) njeh me historikun e kinemasë botërore dhe shqiptare;
-) njeh ndërtimin e kamerës me film dhe atë digjitale;
-) praktikon dhe krijon një etyd të thjeshtë filmik.

2. Përmbajtja tematike e lëndës Fotografi

Tematika	Tematika	Rezultatet e pritshme	Orët
Problemet komplekse teknike dhe estetike te fotografisë	1.1.Njohje e përgjithshme e objektiveve 1.2.Ndërtimi i objektivit 1.3.Objektivat me distancë fokale fikse, (prime lenses) 1.4.Objektivat me distancë fokale të ndryshueshme, (zoom lenses) 1.5.Objektivat kënd gjerë, (Wide Angle Lenses. 1.6.Objektivat me kënd normal, (Standard angle lenses) 1.7.Objektivat kënd ngushtë, (telephoto lenses) 1.8.Thellësia e fushës së fokusit, (depth of field) 1.9.Tri elementet që kontrollojnë thellësinë e fushës së fokusit. Diafragma, Distanca fokale e objektivit, Distanca midis Aparatit dhe subjektit 1.10.Detyrë praktike	<i>Nxënësi/ja:</i> <ul style="list-style-type: none">) praktikon në mënyrë efektive gjetjen e karakterit të maskës.) praktikon dhe realizon ndërtimin e maskës në volum.) përvetëson teknikën e realizimit të negativit në allci.) realizon me sukses një maskë me të gjitha detajet e nevojshme. 	70 orë
	2.1 Njohje me teknikën e ndriçimit 2.2 Temperatura e ngjyrës në	<ul style="list-style-type: none">) njeh me teknikat bazë të ndriçimit.) kupton ndryshimin 	54 orë

Parimet e elementeve të ndriçimit	<p>ndriçim</p> <p>2.3 Njohje me ndriçimin natyral</p> <p>2.4 Njohje me ndriçimin artificial.</p> <p>2.5 Njohje me pajisjet teknike të ndriçimit</p> <p>2.6 Njohje me filtrat xhelatinë dhe filtrat xham</p> <p>2.7 Detyrë praktike portret, bust me teknikat e ndriçimit në studio</p>	<p>midis ndriçimit natyral dhe atij artificial.</p> <p>) realizon detyrat praktike portret dhe bust me teknikat e mësipërme.</p>	
Arti i kinemasë	<p>3.1. Histori e shkurtër e kinemasë botërore</p> <p>3.2. Histori e shkurtër e kinemasë shqiptare</p> <p>3.3. Njohje me ndërtimin e kamerës filmike</p> <p>3.4. Njohje me ndërtimin e kamerës digjitale</p> <p>3.5. Njohje me llojet e planeve në kinema</p> <p>3.6. Njohje me teknikën e montazhit</p> <p>3.7. Njohje me programet bazë të montazhit</p> <p>3.8. Njohje me pajisjet teknike të lëvizjes së kamerës</p> <p>3.9. Detyrë praktike “Etyd filmik”</p>	<p>) njeh me historikun e kinemasë botërore dhe atë shqiptare;</p> <p>) njeh ndërtimin e kamerës me film dhe asaj digjitale;</p> <p>) kupton prerjet e planeve dhe gjuhën filmike;</p> <p>) realizon me teknikën dhe programet bazë të montazhit;</p> <p>) krijon një produkt të thjeshtë filmik me njohuritë e mësipërme.</p>	60 orë
Fotografia në natyrë. (Wild life and outdoor)	<p>4.1. Set fotografik peizazhi në natyrë</p> <p>4.2. Set fotografik “Subjekti në marrëdhënie me natyrën”</p> <p>4.3. Set fotografik “Trashigimia kulturore”</p>	<p>) krijon një set fotografik në natyrë;</p> <p>) krijon një set fotografik me temë “Trashëgimia kulturore”;</p>	20 orë

3.VLERËSIMI

Nxënësi/ja është i nivelit MJAFTUESHËM

Nxënës/ja arrin këtë nivel, kur:

-) njeh minimalisht objektivat dhe ndërtimin e tyre;
-) njeh minimalisht pajisjet kryesore të ndriçimit;
-) njeh pak funksionimin dhe ndërtimin e kamerës me film dhe atë digjitale;
-) kryen të paktën një detyrë praktike të dhënë gjatë vitit.

Nxënësi/ja është i nivelit MIRË

Nxënësi/ja arrin këtë nivel, kur:

-) njih mesatarisht objektivat dhe ndërtimin e tyre;
-) njih mesatarisht objektivat kënd gjerë, normalë dhe kënd ngushtë;
-) njih mesatarisht pajisjet kryesore të ndriçimit;
-) njih mjaftueshëm historikun e kinemasë botërore dhe shqiptare;
-) kryen pjesërisht detyrat praktike të dhëna gjatë vitit.

Nxënësi/ja është i nivelit SHUMË TË MIRË

-) njih saktë objektivat dhe ndërtimin e tyre;
-) njih saktë dhe është krijuar me objektivat kënd gjerë, normalë dhe kënd ngushtë;
-) njih saktë pajisjet kryesore të ndriçimit;
-) realizon saktë detyrat me ndriçim natyral dhe artificial;
-) njih më së miri historikun e kinemasë botërore dhe shqiptare;
-) njih më së miri funksionimin dhe ndërtimin e kamerës me film dhe atë digjitale;
-) realizon me sukses një etyd të thjeshtë filmik.

Dega: ARTI FIGURATIV - PIKTURË
Specialiteti: Fotografi
Klasa: 12-të
Kohëzgjatja: 34 javë x 8 orë/javë = 272 orë

1. Rezultatet e pritshme

Në përfundim të këtij programi, nxënësi/ja:

-) njeh dhe kupton pajisjet laboratorike të larjes dhe stampimit të fotos;
-) praktikon proceset e zhvillimit të filmit bardhë e zi dhe me ngjyra
-) praktikon proceset e stampimit të fotografisë bardhë e zi dhe me ngjyra;
-) njihet me mediumin e video art dhe artistët që e prezantojnë video art;
-) kupton se çfarë e ndryshon video art me kinemanë dhe tv;
-) krijon një detyrë në mediumin e video art;
-) realizon me sukses detyrën e diplomës duke u bazuar në të gjitha teknikat dhe mediumet që ka mësuar.

2. Përmbajtja tematike e lëndës Fotografi

Tematika	Tema mësimore	Rezultatet e pritshme	Orët
Pajisjet laboratorike të larjes dhe stampimit të fotos, bardhë e zi dhe me ngjyra.	1.1. Dhoma e errët	<p><i>Nxënësi/ja:</i></p> <ul style="list-style-type: none">) njeh pajisjet laboratorike për zhvillimin dhe stampimin e filmit bardhë e zi;) njeh pajisjet laboratorike për zhvillimin dhe stampimin e filmit me ngjyra;) praktikon procesin e zhvillimit të filmit pozitiv (reversal) bardhë e zi;) praktikon procesin e zhvillimit të filmit pozitiv (reversal) me ngjyra;) realizon një set fotosh të stampuara nëlaborator me teknikat e mësipërme. 	120 orë
	1.2. Solucionet për procesimin e filmit negativ bardhë e zi		
	1.3. Koha e nevojshme për procesimin e filmit negativ bardhë e zi		
	1.4. Solucionet për procesimin e filmit pozitiv bardhë e zi (reversal process)		
	1.5. Koha e nevojshme për procesimin e filmit pozitiv bardhë e zi (reversal process)		
	1.6. Njohje e përgjithshme mbi procesin e stampimit		
	1.7. Solucionet përkatëse për procesin e stampimit në teknikën bardhë e zi		
	1.8. Koha e nevojshme e procesit të stampimit në teknikën bardhë e zi		
	1.9. Solucionet përkatëse për procesin e stampimit në		

	<p>teknikën me ngjyra</p> <p>1.10. Koha e nevojshme e procesit të stampimit në teknikën me ngjyra</p> <p>1.11 Filtrat e nevojshëm dhe përdorimi i tyre në procesin e stampimit bardhë e zi</p> <p>1.12 Filtrat e nevojshëm dhe përdorimi i tyre në procesin e stampimit me ngjyra</p> <p>1.13 Detyrë praktike për njohjen e proceseve laboratorike</p>		
Video Art	<p>2.1. Një histori e shkurtër mbi video art</p> <p>2.2. Artistët kryesorë të video artit</p> <p>2.3. Çfarë e ndryshon video art me kinemanë dhe tv</p> <p>2.4. Video arti në Shqipëri Artistët që e përfaqësojnë</p> <p>2.5. Detyrë praktike “Poezi e përkthyer në imazh”</p>	<p>) kupton se ç’është video art;</p> <p>) njeh artistët kryesorë të këtij mediumi;</p> <p>) kupton ndryshimin midis video art dhe filmit apo tv;</p> <p>) realizon me sukses një detyrë në këtë medium.</p>	64 orë
Projekti diplomës:Foto, Film i shkurtër, Video art, Video instalim. Temë e lirë	<p>3.1. Diskutim mbi projektet individuale</p> <p>3.2. Materiale ndihmëse. Projekttime foto, video art, filma</p> <p>3.3. Konkretizimi i ideve në fazën e parë të realizimit Foto, video art, film i shkurtër</p> <p>3.4. Faza e dytë e realizimit. Post produksion Foto-editim, video editim</p> <p>3.5. Faza e tretë Detajimi i projekteve, foto, video, film</p> <p>3.6. Faza e katërt Organizimi i hapësirës së</p>	<p>) realizon me sukses detyrën e diplomës bazuar në të gjithë informacionin e marrë në tre vite.</p>	88 orë

	ekspozimit 3.7 Mbyllja e detyrës dhe prezantimi final		
--	---	--	--

3.VLERËSIMI

Nxënësi/ja është i nivelit MJAFTUESHËM

Nxënësi/ja arrin këtë nivel, kur:

-) një pak pajisjet laboratorike të larjes dhe stampimit të fotos;
-) një pak historikun dhe artistët që përfaqësojnë video art;
-) kryen të paktën një detyrë praktike të dhënë gjatë vitit;
-) realizon minimumin e detyrës së diplomës duke u bazuar në të gjitha teknikat dhe mediumet që ka mësuar.

Nxënësi/ja është i nivelit MIRË

Nxënësi/ja arrin këtë nivel, kur:

-) një mjaftueshëm pajisjet laboratorike të larjes dhe stampimit të fotos;
-) një mjaftueshëm proceset e zhvillimit të filmit bardhë e zi dhe me ngjyra;
-) një mjaftueshëm proceset e stampimit të fotografisë bardhë e zi dhe me ngjyra;
-) një mjaftueshëm historikun dhe artistët që përfaqësojnë video art;
-) realizon mesatarisht një detyrë në mediumin e video art.
-) realizon mesatarisht detyrën e diplomës duke u bazuar në të gjitha teknikat dhe mediumet që ka mësuar.

Nxënësi/ja është i nivelit SHUMË TË MIRË

Nxënësi/ja arrin këtë nivel, kur:

-) një dhe kupton saktë pajisjet laboratorike të larjes dhe stampimit të fotos;
-) një dhe praktikon proceset e zhvillimit të filmit bardhë e zi dhe me ngjyra;
-) një dhe praktikon proceset e stampimit të fotografisë bardhë e zi dhe me ngjyra;
-) përvetëson saktë mediumin e video art;
-) një mirë historikun dhe artistët që përfaqësojnë video art;
-) realizon saktë një detyrë në mediumin e video art;
-) realizon me sukses detyrën e diplomës duke u bazuar në të gjitha teknikat dhe mediumet që ka mësuar.